

BIBLIOTEKA
SHTETIT

81H-2

K95

Fadil Kroja



komedi

LUANI I SHTEPËSE

8H-2


K95

FADIL KRAJA

Kjo komedi ka fituar çmimin e parë në konkursin
kompletar të dramaturgjisë organizuar për vitin 1945
32-vite më parë në themelimin e Partisë.

LUANI I SHTËPISË

komedi



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»


ALABIA KRALA

847-2-108
K 97

Kjo komedi ka fituar çmim të dytë në konkursin kombëtar të dramaturgjisë organizuar për nder të 35-vjetorit të themelimit të Partisë.

LUANI I SHTËPISË

libretti



SHTËPIA BOTUESE 'LUANI I SHTËPISË'

PERSONAZHET:

BUSHI — punëtor në një ndërmarrje

NORA — e shoqja

LULJA — e bija

LANDI — një komshije

BATO — roja i ndërmarrjes

SOKRATI — nëpunës

I PARI

I DYTË

NJË MAMI

Ngjarje e ditëve tona.

PROLOG

Në dhomën e pritjes në maternitet. Dy-tre burra që presin.

BUSHI — (Të parit) Pret?

I PARI — Pres...

BUSHI — Edhe unë pres...

I PARI — Shihet!..

BUSHI — Sa herë ke ardhur këtu?

I PARI — Si?

BUSHI — A ke fëmijë?

I PARI — Jo. Vjet jam martuar...

BUSHI — I lumi ti!

I PARI — Pse?

BUSHI — (Pak nërvöz) Tash e kupton më vonë psë-në! (Pauzë e gjatë) Dhe vij për të gjashtën herë këtu!...

I PARI — Si?

BUSHI — Gjashtë, pra!

I PARI — Sa i lumtur duhet të jesh!

BUSHI — Unë?!.. (Qesh) Hë!.. Një fjalë gojë! I lumtur!... Është si punë zareshe... I hodhe, të ra dopio gjashta, fitove, nuk ke nevojë të luash më! Përndryshe, o burra, hidh zaret!..

I PARI — Nuk ju kuptoj!

BUSHI — Tash e kupton më vonë...

I PARI — A është zor?

BUSHI — Për çfarë... Të presim këtu?

I PARI — Jo e kam fjalën për atje... (*Tregon maternitetin*) për... lindjen...

BUSHI — (*E shikon me habi*). Ku di unë... Gruaja lind e jo unë.

I PARI — Më fal... Vërtetë jam hutuar... Jam në ankth!

BUSHI — Po, xhanëm, nuk ke faj. Je së pari... (*Pauzë*) Çfarë pret?

I PARI — Si çfarë pret? Gruan natyrisht.

BUSHI — E kam fjalën, djalë apo vajzë?

I PARI — Te gruaja e kam mendjen... Të shpëtojë ajo!

BUSHI — (*Me interes*) Pse? Është e sëmure?!

I PARI — Natyrisht...

BUSHI — Çfarë ka?

I PARI — (*Qesh*). Ti tallesh!... Çfarë ka, thotë!

Si gruaja jote është...

BUSHI — Dhe për këtë merakosesh?

I PARI — Pak të duket?

BUSHI — Dhe shumë jo!.. Të thashë se gruaja ime vjen për të gjashtë herë këtu!

I PARI — Po, më sa shoh, edhe ju jeni i shqetësuar!...

BUSHI — Jam, posi... Bile më shumë se ti! Po me një kuptim tjetër... se unë pres djalin!

I PARI — Vajza i ke fëmijët e tjerë?

BUSHI — (*Si në vaj*) Vajza!... (*Tregon gishtat e dorës*) Pesë!

I PARI — I lumi ti!.. Vajzat janë të dashura...

BUSHI — (*Ngrihet nervoz*) Dëgjove? I lumi ti, tho-

të! Njëzet mijë herë këtë fjalë... E pra, dëgjo këtu! Unë i kam thënë gruas: «Ose më bëj djalin ose vitin e ardhshëm përsëri në maternitet do të vish... Gjashtë... shtatë... dhjetë herë, derisa të dalë djali... (Pauzë) E ti jargavitesh për një vajzë... (Largohet, shkon tek tjetri që rri shumë mendueshëm) Po ti, pret?

I DYTI — Me padurim... Jam shumë i shqetësuar...

BUSHI — Mos u mërzit... Ja, do ta marrësh vesh!

I DYTI — Natyrisht po kam edhe një hall tjetër...

Ku më takoi sot të vij në maternitet!..

BUSHI — Më mirë sot se nesër...

I DYTI — Kam lidhur bast me një shok... nuk e di si do të shkojë puna.

BUSHI — Jo, vëlla, nuk i besoj fatit... Jam dje-gur pesë herë...

I DYTI — Unë i besoj... Si thua?... Unë them nja katër!..

BUSHI — Sa?

I DYTI — Katër... bile më shumë!

BUSHI — Pse, mor, ç'u bë ajo?... S'po të marr vesh se për kë flet!

I DYTI — Po një skuadër e dobët është... Vjet ishte në kategori të dytë...

BUSHI — Po ti... hej, bela...

I DYTI — Për ndeshjen që luhet sot në stadium...

BUSHI — Po këtu pse ke ardhur?

I DYTI — Këtu?... Për gruan... por edhe futbollin e dua shumë...

BUSHI — Ik, or, tutje! Çfarë njerëzish mban kjo tokë... (Të parit) E dëgjon burrin e botës? Ne na digjet mjekra e ai kërkon të ndezë cigaren...

Hyn mamia e i bën në shenjë të dytit.

MAMIA — Gruaja juaj lindi dy binjakë!

I DYTI — Bukur fort!

MAMIA — Me operacion...

I DYTI — I lindi veç...

MAMIA — (Nervoze) E, si urdhëron! I lindi...

I DYTI — Bukur fort! Kaq kisha... I bëj të fala!...
(Largohet).

(Ndërsa mamia thërret të parin)

BUSHI — Çudi!.. Këta njerëz në vend të kokës kanë top futbollit! (Pauzë) Kujt i lindi dy djem?... E ku di ai së ç'është djali? Budallai... Unë plasa për një... ai dy përnjëherësh e nuk e çan kryet fare...

MAMIA — (Të parit) Urime, shok... Gruaja të lindi një vajzë të bukur si pëllumb...

I PARI — Ajo, si është?

MAMIA — Shumë mirë... Të dërgon përqafime!

I PARI — (Përmalluar) Mos ka nevojë për ndonjë gjë?

MAMIA — Asgjë... Nesër dil andej nga kopshti e mund ta shohësh nga dritarja gruan...

I PARI — (I puth duart mamisë) Faleminderit shumë faleminderit... (Bushit) Sa i lumtur që jam! Ajo është mirë... Ju kishit të drejtë...

U dashka provuar lumturia... (E përqafon pëpritur) Ju faleminderit shumë... (Del)

BUSHI — Mojt motër, si i pat hallet ky? Më duket se... (Luan dorën).

MAMIA — Nga gëzimi, shok, nga gëzimi...

BUSHI — Për një vajzë?.. Pse nuk më tha, mojt, se po ia falja edhe unë nja dy...

- MAMIA — (*Serioze*) Tani e kini radhën ju!
- BUSHI — E di... Unë gjithmonë në fund, si rrezik-
ziu...
- MAMIA — Gruaja juaj lindi djalë!
- BUSHI — E dija unë... Nuk kam fat! (*Përmendet*)
Si the? Dj-a-a-lë?!
- MAMIA — Katër kilogramësh!
- BUSHI — Djalë, ti the djalë?
- MAMIA — Po, pra!
- BUSHI — Hë, si tallet shejtania...
- MAMIA — Jo, unë nuk tallem...
- BUSHI — Djalë?! Edhe e thua kaq thatë?... Prit,
moj, pak...
- MAMIA — Mos u bëj si fëmijë...
- BUSHI — (*Pickon veten*) Jo për nder... Nuk jam
në ëndërr. Si the, djalë?
- MAMIA — Sa herë doni t'jua përsëris?!...
- BUSHI — Mos u mërzit, ti, shoqe... Kam hall
unë!...
- MAMIA — Jo, s'kam pse mërzitem.
- BUSHI — Prit pak do... A e pe mirë?
- MAMIA — Cilën, gruan?
- BUSHI — Atë, moj, atë që lindi... A ishte djalë
tamam?
- MAMIA — (*Qesh*) Një copet!
- BUSHI — Ta marrsha të keqen!
- MAMIA — Kujt i thoni?
- BUSHI — Ty! Ty ta marrsha të keqen e të hangërt
goja mjaltë e llokum... e çka të dojë e bardha
mori zemër!...
- MAMIA — Gruas, gruas sate thuaj... Dhe kujdesu
për të... Është dobësuar shumë...
- BUSHI — Të kujdesem, thua?... Tani që më bëri dja-
lin?! Dëgjo, i thuaj... që të ruajë shëndetin dhe

atë... djalini!.. Për të tjerat të mos bëhet merak... Mendon Bushi për të!... Edhe qumësht dallëndysheje do t'i dërgoj... Edhe hurma arabie... edhe banane që kanë vitamina... e që qërohen nga koka!..

MAMIA — Hajde, urime... Shkova unë se kam punë...

BUSHI — Shko, ta marrsha të keqen. Shiko punën, ti!

Porsa mamia del, bie perdja. Bushi ngel para perdes. Nga megafoni dëgjohej kënga: «O miqtë e mi më lindi një fëmi!»

(Spektatorëve) Dikur as që e dëgjoja dot këtë këngë!.. Më dukej se tallej me mua.. Tani po, tani ka tjetër shije!... *(Këndon)* «Trashëgimtari im jeton, tra la la la, tra la la la...» *(Pauzë. Dëgjohej prapë kënga)* Ndoshta dukem pak qesharak, por si të them... Çështja e djalit është një çështje e thellë filozofike se, që ta kam llafin, edhe vajzat duhen, se pa to nuk kalohet jeta... Kurse djali është ndryshe... Nuk them se po' më mbetet pushka varë, se sot edhe vajzat po e mbajnë... por, si të them, fjala «djalë» edhe gojën sikur ta mbush plot!... DJALË!...

(Hyn Sokrati) Shoku Sokrat, më uroni!..

SOKRATI — *(Me gjyslykë)* Për çfarë, ju lutem shumë?

BUSHI — *(Fërkon duart)* Si të them, d.m.th., unë, u bëra me trashëgimtar, me një djalë katër kilogramësh... Tani, posa e mora lajmin e gëzuar...

SOKRATI — Punë e madhe fort!...

BUSHI — (I habitur) Si thatë?

SOKRATI — (Ndërron ton) Gjë e madhe djali...
Hajde, urime!..

BUSHI — Urime paç e të na urdhëroni në shtëpi!..

SOKRATI — Natën e mirë!..

BUSHI — Të mirë e të ëmbël e bëfsh... (Sokrati
del. Kënga vazhdon) Hajde, Vaçe, se na këna-
qe!... (Del)

TABLO I

Shtëpi e zakonshme. Dhomë me orendi të ndryshme e një tryezë në mes. Nëna po rregullon tryezën. Jashtë dëgjohet një krismë e një britmë gruaje. Është Landi që dikë shan.

NËNA — Prapë Luani. Diçka bëri përsëri. (*Ngrihet dhe shikon nga dritarja.*) Bobooo! Teto Landi qenka xhindosur! Po ma ndjek djalin me shkop në dorë! Ndonjë të zezë ia ka bërë Luani se kot nuk e ndjek!... (*Hap dritaren e thërret.*) Luan, Luan more! Ec në shtëpi, more i shkretë, se na turpërove!.. Ec në shtëpi, more, paç faqen e zezë... (*Përsëri krismë, përsëri sharje nga Landi. Nëna mbyll dritaren.*) Ç'na gjeti me këtë djalë! Kam pesë vajza e nuk i dëgjohet zëri i gojës!... Po ma shkurton jetën... (*Thërret*) Lule, Lule moj!

Lulja duket në portë me një përparse në bel. Duart i ka me miell.

LULJA — Urdhëro!

NËNA — Shko, moj bijë, e shiko ç'po bën Luani. Po ma shkurton jetën!

LULJA — Llastojeni ju, llastojeni... Pritni sa të rritet edhe pak...

NËNA — Shko, moj bijë, e sille në shtëpi... Ti e di që është i jati që e ledhaton...

LULJA — Kurse ti hesht. (Pauzë) Nënë, më mirë shko ti, se po shkova unë do, ta rrah!
(Përsëri zhurmë)

NËNA — Nuq fitohet gjë me dajak moj bijë, atë vëlla keni...

LULJA — A e shikon? Mbrojeni pra...

NËNA — Shkò, bijë, se po më shtie në dhe të gjallë...

Lulja bën të dalë, duket Landi si i xhindosur.

LANDI — Ku është?

LULJA — Atë po kërkojmë edhe ne...

NËNA — E zeza unë!... (Ulet në karrige)

LANDI — Ku është i paudhi se do t'ia shkurttoj veshët!

LULJA — Ç'të ka bërë, teto Landi?... Dëgjova një britmë...

LANDI — Ç'po i bën gjithë lagjes, thuaj... Malukati! (Shikon nënën) Pse më rri ashtu si qyqe?

NËNA — Se nuk kam gojë të flas...

LANDI — Ke pesë vajza për nderë... Po ky nga doli kaq i zi?... (Del duke bërtitur) Ku je, ore mistrec?... Ku je, ore i paudhë?!

NËNA — (Me vete) Plase për djalë, o burrë, ja ku e ke! Po ia nxin faqen gjithë konakut... Po kur të rritet?

LULJA — Nuk do ta lëmë kështu, nënë!

NËNA — Një fjalë goje...

LULJA — Të gjithë kemi faj, nënë, jo vetëm babai...

- (Imiton) Djali! Djali! Luani i shtëpisë!... Mirë babai, se luan mendësh pas tij, po ne ç'bëmë për të? Pse e lejuam? (Pauzë) Megjithatë nuk jemi vonë...
- NËNA — (Ngrihet në këmbë e shqetësuar) Po vjen babai, e ai kërkund!... Hiç mos luaj!... (I del përpara të shoqit, i cili që nga jashtë lëshon ca kollitje sinjali).
- BUSHI — (Ulet rëndë në karrige, e bija e ndihmon të heqë pallton) Luani ku është?
- NËNA — (Me kast) A u lodhe?
- BUSHI — (Nervoz) Ta merr mendja që u lodha! Ku është djali? (Bërtet) Luan!...
- LULJA — Nuk të dëgjon, baba!... Kushedi ku është futur nëpër lagje...
- BUSHI — Tani në këtë orë?
- LULJA — Nuk e gjen gjë, baba, djalë është...
- BUSHI — (E kupton ironinë) Djalë, ta merr mendja... Jo flokëgjatë e mendjeshkurtë si ti... (Vajza do të flasë) Ik, këput qafën!
- LULJA — Nuk bëra gjë, baba, përse më përzë?
- BUSHI — Ik kërko djalin, pastaj llafosemi bashkë... (Vajza, pas shenjave që i bën e ëma, del) U rritën grua! Filluan telashet... Në fillim iu del llapa... pastaj të tjerat...
- NËNA — Me nder po rriten... Shiko djalin ti që nuk po lë dy gurë bashkë...
- BUSHI — Djalin, djalin... Aty ju rreh mendja të gjithëve... Po djali lahet me një filxhan ujë, kurse vajza...
- NËNA — Të thashë... me nder po rriten...
- BUSHI — Sepse i kemi nën kontroll!... Po a i ke vazhdimisht? Kjo e madhja diskuton nëpër mbledhje, kritikon drejtorë e shefa. dhe harron

se është vajzë... Harron se po ia mbyll derën vetes...

NËNA — *(Tund kokën mendueshëm tek po arnon një këmishë)* Shiko si e ka bërë këmishën e re! Copë-copë! Para një jave ia blemë... Shiko pantallonat e rrapatushit tënd... Copë-copë i ka bërë ndër ferra...

BUSHI — *Pesë vajza ke, a t'u përzieva në to?...*
Jo! Edhe emrat ia ngjite vetë... Njëres Lule, tjetrës Vjollcë, së tretës Gonxhe! Pastaj... *(mendon, e shoqja qesh)*... hë, Burbuqe, pastaj Shaqe! Të gjithë emra lulesh... Ka marrë erë shtëpia prej tyre... Ky i gjashti doli djalë... Këtë ma leni mua... Apo s'ia kam ngjitur emrin Luan!.. Ju merruni me lulet...

LANDI — *(Që nga jashtë)* I paftyri, edepsëzi, malukati, sherri i lagjes, turpi i shtëpisë... *(Hyn)* Mirëmbërëma!..

BUSHI — *(I djeg miza)* Mirë se vjen, Landi... Urdhëro, motër... Grua, piqja një kafe me shumë sheqer...

LANDI — Me zehër, të ma piqni!

BUSHI — *(I habitur.)* Mirë, si ta dojë qejfi...

LANDI — Edhe po tallesh, ë?... Akoma nuk ka ardhur, ë?... Ka frikë se ia jap veshët në dorë...

BUSHI — Kujt, moj?

LANDI — Tët biri!

BUSHI — Luanit?

LANDI — Shejtanit!?

BUSHI — Ç'punë ke ti me veshët e tij?

LANDI — Po ai ç'punë pati me xhamet e dritareve të mia? Katër xhame më theu, moj motër...

LULJA — I ka ngjarë babait, moj teto Landi, është gjahtar...

BUSHI — (*Lules*) Tash po ta tregoj gjahtarin pastaj...
(*Landit*) Ku është Luani?

LANDI — Mua më pyet?.. Hajde, baba! Vetem t'ënde pyet!...

BUSHI — (*Fërkon duart*) Tashi, teto Landi, fëmijë janë...

LANDI — Fëmijë janë edhe vajzat e tua, që nuk u dëgjohet zëri për të keq...

LULJA — Po nuk mund të bëhen gjahtarë, të gjithë, teto!

BUSHI — (*Shikon të bijën me inat. Landit*) Tani, shoqja komshije, e di se ka një llastik... Bën prova...

LANDI — More, me xhamet e mi do bëjë prova ai?

LULJA — Jo, tete, bën edhe në shkollë... Merr ndonjë katër!.. Prova janë...

BUSHI — (*Të bijës*) Mbylle gojën ti! (*Landit*) Së pari, shoqja Landi, mati fjalët mirë me mua, kupton? Jam baba gjashtë kalamajsh unë! E dyta, sa xhame u thyen?

LANDI — Katër, copë-copë...

BUSHI — (*Nxjerr lekët*) Urdhëro lekët. Së treti, nuk u bë qameti, kupton?

LANDI — (*Shikon lekët*) Ashtu, ë? Tani u dashka që unë të shkoj në dyqan në këtë orë e të marr xhamet, kupton? Pastaj të thërres' ustanë e të m'i vërë kur t'i vijë radha, kupton? (*I kthen lekët*) Jo, mor të keqen, ne do të vep-rojmë ndryshe... Së pari hiq xhamet e dritares sate, së dyti eja e m'i ve ndër dritaret e mia, së treti ose mblidhja atij trashëgimtari ose përndryshe do të shkoj të ankojem në këshillin e lagjes, dhe në shkollë! Kupton?

NËNA — E mori vesh...
BUSHI — Posij, moj, këshilli i lagjes atë punë ka, të
merret me xhamet e Landit...
LANDI — Ka, s'ka, unë kështu po të them...
Hyn Bato me çifte në krah.

BUSHI — Kështu pra, Land, kupton? Tani mund
të shkoni... Ne këtu jemi... U muarëm vesh...

LANDI — Si u muarëm vesh, do m'i vesh xhamet
apo jo?

BUSHI — Merri pra lekët... *(Të shoqes)* Më bëj
gati rrobot e gjahut!...

LANDI — Unë nuk luaj prej këtu... Ndryshe...

BATO — Si është puna, moj shoqëri?

BUSHI — Për katër xhame tërë kjo s'është!

LULJA — Djali qoftë...

BATO — Hajt, se nuk u bë qameti... Sonte është
natë rosash... Po vramë gjë, ta sjellim edhe
ty një, shoqja Landi...


LANDI — Ama për gjahtarë që jeni ju, rosat t'ju
ishin ulur në oborr si pulat... *(Bushit)* Ke gruan
pulë ti, se po të isha unë në vend të saj, ia
rregulloja atij Luanit tënd... E bëja qengj fa-
re...

Nëna hyn e alarmuar me një rrip pa fishekë.

BUSHI — Ku janë fishekët, moj?

NËNA — Andej në aneks i ke... Në kazan të ujit...

BUSHI — *(Pasi del e hyn përsëri)* Uuuu!... Çka më
ka gjetë! Bato, mor, unë ngela pa fishekë, mor!
Aman, mor, po ku është, mor? *(Bërtet)* Luan
more! Luuaan! Ku je, mor den e bir qeni!...



LANDI — Bush, unë dua xhamet.
BUSHI — M'u hiq sysh... Shkoj, moj, e merril gjithë
xhamet e shtëpisë! Si t'ia bëj për fishekët?
Është racioni i tërë vitit, moj!
LULJA — Mos bëj ashtu, baba, se nuk ka lezet!
Fundja, fëmijë, është! Ka dashur të bëjë pro-
va...

BATO — Mirë e ka Lulja, fëmijë është... Nuk bëhet
gjahtar menjëherë!...

LANDI — Unë dua xhamet!

NËNA — Fëmijë është, djali i nënës...

BUSHI — Çfarë fëmijë, moj! M'u hiq sysh, Landi,
me gjithë xhamet! Ku është, moj? Ma sillni
këtu, se pasha rininë time bëra hatanë në të...

BATO — Fëmijë është...

LULJA — Fëmijë është...


NËNA — Kërthi është...

BUSHI — E kam fajin unë!

Bie perdja.

LANDI — Aja për gjatë të jetës...
BUSHI — Aja për gjatë të jetës...
LULJA — Aja për gjatë të jetës...
NËNA — Aja për gjatë të jetës...
BATO — Aja për gjatë të jetës...

BUSHI — Ku janë fishekët, moj?
NËNA — Aja për gjatë të jetës...
BUSHI — Aja për gjatë të jetës...
LULJA — Aja për gjatë të jetës...
NËNA — Aja për gjatë të jetës...
BATO — Aja për gjatë të jetës...



PARASKENË

Para hurrjes së një ndërmarrjeje. Përkarshi dera e një klubi. Para portës me hekura rri mbi karrige, xha Bato.

BATO — *(Njërit që del)* Natën e mirë, shpirt. *(Të tjerëve)* Natën, natën, sheqer e mjaltë... *(Bushit del i lodhur)*

BUSHI — Natën... Bato!

BATO — T'ëmbël e të mirë, shpirt i Batos... U, ti qenke, Bush?

BUSHI — Unë jam, po, mos më ndal se nuk kam nge...

BATO — Cigare, a ke?

BUSHI — Cigare kam por mos më ndal se më griu uria... As drekë nuk kam ngrënë... *(I jep cigaren)*

BATO — Jo, ore, nuk të ndal! Uria është gjë e madhe...

Shkoj në shtëpi, gruaja kishte blerë një qefull... Po sa ishte, thua ti? Po, dy kilo i kishte me kaull. *(Bato i zgjat muhabetin, Bushi dëgjon e lëpihet)* Gruaja nuk e kishte prekur fare... Se, që ta kam llafin, qefulli do specialitet e unë jam usta... E mora, që thua, ti zot-

rote, e qërova në fillim... (Bën lëvizjet) Pastaj i bëra ca të çara përsëgjati, dhe për çdo të çarë nga një thelë hudhër... Pastaj mora një furcë dhëmbësh që e përdor vetëm për peshkun... E zhyta në vaj ulliri safi... dhe i rashë qefullit... Pastaj e vura në skarë... Erdhi e t'u skuq... Pastaj e kapa qefullin për koke dhe e shkunda...

BUSHI — (Duke u lëpirë) Si e shkunde?

BATO — Po pra, e shkunda... (Bën me dorë sikur e shkund) Gjithë mishi ra në piatancë, ngeli vetëm koka dhe skeleti që kullonte lëng... Griva pak qepë e majdanoz... pastaj një limon e ndava përgjysmë e nisa ta hedh në piatancë.

(Bën sikur po shtyp limonin)

BUSHI — (Kujtohet që Bato po tallët me të) Mjaft, he dreq, se ma çove gojën lëng... Ti e bën apostafat që të më grijnë zorrët më shumë...

BATO — (I jep kutinë i qetë) E shikon atë klubin atje! Po të ishte për mua e mbyllja, ose nuk e furnizoja me raki e birrë!

BUSHI — Pse ore? Ne shyqyr që e kemi...

BATO — Sa njerëz si ti dalin të uritur... Në shtëpi i pret gjella e ngrohtë, ndërsa këtu ia bën me sy birra me qofte, rakia me salçice, dhe ndalen sa me e thye me një të vogël! (Bën me gisht) Mirëpo ajo e vogla sjell edhe tjetrën pas e kështu... Unë i shoh prej këtu... Disa dalin balenë...

Hyn i pari

I PARI — (Duke hyrë) Mirëmbërëma... Ju jeni ro-ja?

BATO — Unë jam, moj shoqëri...

I PARI — Mos ka lënë shef Sokrati një reflektor për mua?

BATO — (*Hyn në kamare e del me një reflektor*) Urdhëro, dhe më ka porositur t'ia ndreqësh mirë...

I PARI — Kë të ndreq reflektorin apo shefin?

BATO — Cilin të duash...

I PARI — Isha sot rastësisht në mbledhjen e këshillit teknik... Ama të ndrequr që i bëri një punë-tore, si e quanin, Lule më duket! Ajo ishte zhivë fare.. Të keshë të tillë punë-tore... (*Del. Bato i luan syrin Bushit*)

BUSHI — Ç'ka thënë Lulja për shef Sokratin?

BATO — Po bën një studim që t'i zhvatë ndërmarrjes disa qindra lekë, po një studim që s'i duhet askujt...

BUSHI — Asaj nuk i duhen gjë punët e shefave e të drejtorisë...

BATO — Mor, i lumtë asaj që nuk i bën syri tërt... (*Me gisht*) Ja, po vjen edhe Sokrati! Boboo, sa nervoz qenka... Mirëmbërëma, shoku Sokrat... E mori reflektorin ai punë-tori i meta-likes...

SOKRATI — E di, e di... Mirëmbërëma...

BATO — Si shkon studimi mbi klubin?

SOKRATI — Mirë vete... (*Sheh Bushin që përgatitet të shkojë*) Ju jeni shoku Bushi? Mirë që u takuam... Kisha një fjalë me ju...

BUSHI — Urdhëro, shoku Sokrat...

BATO — Bisedoni ju se unë nuk dëgjoj...

SOKRATI — Ajo vajza juaj, më duket Lule e quaj-në...

BUSHI — Lule ia ka ngjitur e ëma, se nuk i jam përzjerë në punë emrash... Gjithmonë kam

- qenë i mendimit se për njerëzit nuk ka rëndësi emri...
- SOKRATI — Ndërsa unë mendoj se po. Emri duhet t'i përshtatet edhe sjelljes edhe fytyrës së njeriut që e mban... Unë bile, do të bëj një studim në të ardhshmen për këtë... Aty nga viti i ardhshëm...
- BATO — (Me vete) E paska vënë në plan t'i zhvatojë shtetit disa qindra lekë vitin e ardhshëm... I duhen për plazh...
- SOKRATI — Ka shumë rëndësi emri...
- BUSHI — Po unë nuk kuptoj se ç'lidhje ka kjo me vajzën time...
- SOKRATI — O i dashur shoq, ka, ka, ka... e ka!
- BATO — (Me vete) Ka, ka, ka... I ngeli gjilpëra gramafonit...
- SOKRATI — Mua gjithmonë më ka karakterizuar sinqeriteti, principlialiteti, ndaj me ty dua të jem i sinqertë e principlial!
- BATO — Qite të shkretën se ku do të dalë kokrra...
- SOKRATI — Që të jem pra i sinqertë e principlial, jua them që në fillim të debatit tim me ju, se vajza juaj, nuk është Lule...
- BATO — (Me vete) Hë, ia paska therë gishtat më duket Lulja...
- BUSHI — Më fal, shoku Sokrat, se unë përsëri nuk po të kuptoj... Që vajza ime nuk është lule, po që ka emrin Lule, këtë e di...
- SOKRATI — Lule, në kuptimin figurativ...
- BUSHI — Me çfarë kuptimi?
- SOKRATI — Ja, që të flasim me figura...
- BUSHI — Ti më mirë fol me fjalë, mor shoku Sokrat...
- SOKRATI — Shoqja Lule më ka kritikuar rëndë në

mbledhjen e këshillit teknik, si ka fyer rëndë
dinjitetin tim si nëpunës dhe kuadër i ndër-
gjegjshëm i kësaj ndërmarrjeje...

BUSHI — (Serioz) Vajza ime të ka fyer ty? Po më
thuj, or shok, se është gjë që rregullohet...

SOKRATI — Si rregullohet, të lutem shumë!...

BUSHI — Do të shkoj në shtëpi t'ia rregulloj qej-
fin unë... dhe nesër vjen e të kërkon të fa-
lur...

BATO — Çfarë të ka thënë Lulja, shoku shef?

SOKRATI — Më ka fyer rëndë. Bile edhe burokrat
më ka thënë...

BATO — (Me shaka) Ama, këtu e paska shkelur...
Ty, të të quajë burokrat?

SOKRATI — E përse, të lutem shumë? Sepse bëra
disa propozime, me shumë vlerë po të zbatoh-
hen... Do t'i sillnin ndërmarrjes shërbime të
mëdha.

BUSHI — Po vajzës sime ç'iu desh të flistë?

SOKRATI — Ja pra, këtu ta kam llafin, sepse asaj
i mungon sinqeriteti dhe principialiteti...

BUSHI — Mirë, mor shoku Sokrat, ja, sa të shkoj
në shtëpi e po ia ndreq! Është fatkeqësia ime
që kam vajza shumë... Veç telashe të sjellin...

BATO — Mos fol përçart, Bush!

SOKRATI — Mirë e ka, shoku Bush!... Po, ku do ta
gjesh vajzën, të lutem shumë?

BUSHI — Në shtëpi pra!

SOKRATI — (Qesh me ironi) Mua nuk më interesoj-
në fare punët e botës. E kam pasur gjithmonë
për princip. U desh filani me filanen? Po le
të duhen, ç'më duhet mua? U ndanë ose u
rrahën, u dogjën ose u poqën! S'më duhet mua

- fare... Isha në kinema... Bleva dy bileta, një për vete e një për gruan! Radha katër, karrige 1 dhe 2... Kur dëgjoj dy veta duke thënë se filmi trajton temë dashurie... Bile dy të rinj në film përqafohen...
- BATO — *(Me ironi)* Si bre, maskarejtë, edhe përqafohen?
- SOKRATI — Ja, pra, të lutem shumë... Ç'më duhen mua gjëra të tilla? Le të përqafohen!! Unë, si njeri i ndershëm, sjell kokën mënjanë... Shikoj punën time, d.m.th., nuk vete fare në kinema, i shes biletat...
- BATO — Hee, prandaj nuk e realizojnë planin kinematë...
- BUSHI — Mirë, shoku shef, po kjo nuk ka lidhje më duket me mua...
- SOKRATI — Prit, të lutem shumë, se ka lidhje... Them se i shita biletat... Po kush i bleu, thua ti? Ajo që më quajti burokrat, Lulja, bija jote!
- BUSHI — Si? Vajza ime?
- BATO — *(Me vete)* Sokrat maskarai... Me siguri e ka gjurmuar...
- SOKRATI — E, pra, vajza juaj, i bleu të dyja... se me të ishte edhe një djalosh tjetër... Një mësuës më duket...
- BATO — Dhe ti ia shite të dy biletat?
- SOKRATI — Këtu tani qëndron principialiteti im... Ajo më kritikoi, unë nuk i mbaj mëri... Bile i shes edhe biletat!...
- BATO — Po ti i shite se të mbetën në dorë!
- SOKRATI — Ajo po shkonte në kinema pa leje, bile me një djalë. Po unë ndjek principialitetin tim, megjithëse e ndërmarrjes sime, bile e një puno-

20M njësi të ndershëm... Ta të të shkojë, them me
vete, ç'më duhet mua!... Gjersa ka prindër...
të lutem shumë... Po patën një çikë mend, tek
ajo pjesa ku të rinjtë përqufohen, këta le të
sjellin kokën mënjanë, të mos e shohin...

BUSHI — Vajza ime në kinema pa leje, me një
djalë?

SOKRATI — Kjo është puna jote, ç'më duhet mua!
Unë ta pata llafin për çështjen e kritikës së
pavend që më bëri... Së paku, mua, m'u duk
pa vend!... Tani kolektivi e përkrah.. Nejse...
Unë po shkoj tani!... (Del)

BUSHI — Ika, unë, Bato!

BATO — Prit, më jep një cigare...

BUSHI — Cigare nuk të jap... se e di që do të më
ndalosh për muhabet...

BATO — E pe Sokratin? Asnjë punë nuk kishte në
ndërmarrje... Erdhi që të lëshojë helmin ty...
Dhe ja, në klub shkoi... Ti merre me gjakftoh-
tësi... Nuk u bë qameti se shkoi në kinema me
një shok! Mos u bëj fanatik...

BUSHI — E ke lehtë ti, se i martove vajzat...

BATO — Ke vajza për nderë, më dëgjo mua...

BUSHI — Janë pesë, Bato. Dy u rritën, u bënë për
burrë... Ç't'i bësh se djalin e kam të vogël, se
të ishte më i madh, ua vija zagar prapa, kudo
që të shkonin... Por janë pesë...

BATO — Do të martohen me nder...

BUSHI — Kur? Një sahat e më parë ta thyej qafën
te burri...

BUSHI — Ta dish, do t'ia jap Lulen të parit që të
ma kërkojë... Ika unë!... Si tha shoku Sokrat?
Radha katër, karrigja 1 dhe 2, apo jo?

BATO — Pse, mor, në kinema do të shkosh? Mos
luaj mendsh...

Bushi del rrëmbyer
(Spektatorëve) Ka gjithfarë njerëzish... Di ku
e hedh farën e thashethemeve Sokrati!

Bie perdja.

PARASKENË

Skena e shtëpisë. Nëna arnon diçka. Bushi sillet nëpër dhomë duke thithur fort cigaren. Radio jep një këngë gazmore.

BUSHI — Mbylle atë radio se na shurdhove!

NËNA — Është këngë e bukur!

BUSHI — Mbylle të thashë...

NËNA — *(Ngrihet ta mbyllë)* Ti në këmbë ishe. Pse më çon nga puna? Së paku, unë po e bëj një punë, kurse ti na mbyte me atë tym duhani... Ç'ke sot, more burrë? Ç'ka ndodhur? A ka mundësi të ma thuash edhe mua atë çfarë ke? Si nuk fole njëherë mirë, ore burrë? Si nuk ta tha goja një herë një fjalë të ëmbël për mua? Nuk them të më përkëdhelësh se nuk jam mësuar, bile do më vinte për të qeshur po të më përkëdhelje, por një fjalë e ëmbël nuk të kushton asgjë... Jemi burrë e grua e të mirat e të këqijat i ndajmë së bashku...

BUSHI — Nuk ke pasur keq prej meje...

NËNA — Po kë quan mirë ti? Se të polla fëmijë? Se po i rris me nder e me mend në kokë?

Po si nuk pyete njëherë a lodhem, a kam ndonjë hall, ndonjë dëshirë?.. A ëndërroj unë?... Përse?...

BUSHI — Nuk keni halle ju gratë, jo. Dhe më lër rehat tani!... Thashë se pres vajzën tonë të dashur... .

NËNA — Vajza ka shkuar në kinema, do të vijë kur të mbarojë filmi!

BUSHI — Ashtuuu! Pra e ditke edhe ti!?

NËNA — Po, e di.. Ajo m'i thotë të gjitha...

BUSHI — Të gjitha, të gjitha?

NËNA — Të gjitha.. Më ka nënë edhe shoqe!

BUSHI — (I bie kokës) E unë budallai kujtoja se është rastësi, kurse qenka e kurdisur, e planifikuar, në këshillin femëror të familjes...

NËNA — Për çfarë flet, për çfarë planifikimi?

BUSHI — Më mirë hesht, që të mos pëlças unë!

NËNA — Jo, nuk do të hesht. Vetëm këtë fjalë di ti... Ndërsa unë mjaft kam heshtur gjithë jetën. Tani dëgjo këtu. Të është bërë mendja corbë! Nga njëra anë djalin po e llaston dhe po e vështirëson edukimin e tij, nga ana tjetër të ka hyrë një merak anadollakësh, se vajza po të rritet e po të prish namuzin!... Në vend që të gëzohesh që po të rriten, ti je thartuar në fytyrë... Lexo gazetën se çfarë thotë për vajzën tënde: edhe punon mirë, edhe tërc ia ka bërë burokratëve!...

BUSHI — E di, e di...

NËNA — Lexoje, lexoje...

BUSHI — Të thashë se e di...

NËNA — Nuk di gjë, jo... Ti kohët e fundit, vetëm faqen e katërt e lajmet e futbollit lexon...

- (Me tallje) Emrin tënd nuk e pashë të lavdërohet, por vetëm të Lules!
- BUSHI — E ç'do të thuash me këtë?
- NËNA — Asgjë... Ti ndoshta je tek ajo fjala «tjerë», që mbyllte listën e të dalluarve... Si doqoftë, Lulja ishte me emër të plotë!
- BUSHI — Njëlloj është, bija ime është ajo... Kur përmendet ajo, përmendem edhe unë...
- NËNA — Hajde, më thuaj tani, ç'ke që je zomëruar?
- BUSHI — Të thashë, më vonë... dhe pikë! (Hyn Lulja)
- LULJA — (Me një pardsy në dorë) Mirëmbrema!
- NËNA — Mirë se vjen, moj bijë, a u lodhe? (Bushit)
- Foli edhe ti, bablok!
- BUSHI — (Imiton të shogon) Mirë se ordhe, moj bijë, a u lodhe? Si t'u duk filmi?
- LULJA — Hiç nuk më pëlqeu, baba!
- BUSHI — Ashtu? a e pe filmin deri në fund?
- LULJA — (E singertë) Mirë thua, baba, më mirë mos ta shihja!
- BUSHI — Hë de!... Errësirë ishte aty, ë? Përse të shikosh filmin kur ke se ç'bën?
- LULJA — Baba!
- NËNA — T'u thaftë goja!
- BUSHI — (I tregon pardsynë) Páske blerë pardsy të re!
- LULJA — (E shikon dhe qesh) Uh, sa budallaqe që jam... Është e Gëzimit. E kisha vënë sipër se bënte pak ftohtë... E harruam që të, dy...
- NËNA — Kush është ky, moj bijë?
- BUSHI — Gëzimi, moj, nuk e njeh?... Ata ishin bashkë në kinema... E kishin vënë mbi gjunjë, që të mos ti ftoheshin këmbët... Pastaj dolën...

- Gëzimi, i frymëzuar nga filmi, i hodhi mbi supe pardesynë damës së tij... Kështu veprojnë kavalierët e vërtetë...
- NËNA — (Së bijës) Kush është ai, moj bijë?
- LULJA — Një shok i imi, nënë!
- BUSHI — Dhëndëri i ardhshëm... (Bërtet) Pardesyja është në vend të shënjit... Merre, puthe, futi livando dhe ruaje...
- LUANI — (Nga jashtë) Pushoni!
- LULJA — Baba, nëse ke vendosur të më flasësh, mos e ngri zërin. Fëmijët nuk duhet të dëgjojnë... Nuk dua të dëgjojnë edhe ata sa i padrejtë po tregohesh me mua kohët e fundit... (Le pardesynë në një karrige)
- BUSHI — Unë i padrejtë? Dëgjon, grua?!
- LULJA — Po, baba!... Se kush të mbush kundër meje unë nuk e di, por ti duhet të dish se nuk jam e vogël...
- BUSHI — Faktet, bijë e dashur! (Ngre lart pardesynë) Faktet flasin ndryshe!
- NËNA — Plaç, me gjithë fakte!
- LULJA — Punojmë në një ndërmarrje së bashku dhe nuk merr mundimin të pyesësh për mua njerëzit me të cilët punoj!..
- BUSHI — Përse të pyes?
- LULJA — Si punoj, si sillem, ç'mendojnë ata për mua... Kush më mirë se ata më njeh, kush?
- NËNA — Mirë, thotë...
- BUSHI — Natyrisht, grua e dashur, nuk pres fjalë tjetër prej teje... Po unë po pyes pardesynë... Kjo flet më qartë se të gjithë!
- NËNA — Binde mëhallen, mor burrë!
- BUSHI — Punë e madhe! Nuk i jap llogari askujt në

shtëpinë time... Le të dëgjojnë. (Lules) Kujt i more leje që shkove në kinema?

NËNA — Më lajmëroi mua...

LULJA — Nuk ishte vonë, baba, pastaj, edhe vonë po të ishte, tani jam e rritur, di se ç'bëj! Ti ke hallin pse shkova me një shok... Po, baba! Ai, shok ishte! E quajnë Gëzim... Mësues fshati është, djalë i ndershëm është...

BUSHI — Flet kjo për nderin e tij... (Për parde-synë) Përse nuk gjete ndonjë shoqe të shkoje me të?

LULJA — (E prekur) Dëgjo, baba, unë nuk lejoj të më fyesh. Këtë duhet ta kesh të qartë. Nuk lejoj asnjë njeri të më fyejë me të padrejtë... Në kinema shkohet me shoqe e me shokë...

BUSHI — (Së shoqes) Dëgjo, moj, se plasa. Shkuakan shoqe e shokë!... (Lules, duke bërë me dorë nga salla) Pa më thuaj, bijë e dashur, ku qenkan ato shoqe e shokë? Unë atje shoh vetëm të martuar, të fejuar e të dashuruar. Bile të martuar shoh më pak... se zakonisht burrat shkojnë vetëm, kurse, sipas teje, djalë e vajzë qenkan vetëm shokë dhe shoqe e s'paskan asgjë të keqe që rrijnë bashkë!...

LULJA — (Serioze) Baba, ç'ke xhanëm kohët e fundit që je bërë kështu? (I afrohet dhe i vë dorën në sup) Ti e di që jam sekretare e rini-së së ndërmarrjes. Po të ishte ashtu si kujton ti...

BUSHI — (I zënë keq) Mua mos më ngatërro an-dej... Si i thonë të jatit?

LULJA — Shpend!

BUSHI — Po nënën si ia quajnë?

LULJA — Zogë!

BUSHI — Tërë pupla qenkan... Andej pupla, kënde
lule... Do të dalë një bashkim i bukur... Përse
nuk vjen të më kërkojë dorën tënde?

LULJA — Sepse jemi vetëm shokë... të thashë!

BUSHI — (Për pardesynë) Po këtë ku ta çojmë?

LULJA — More baba... (Qesh) Ke dëgjuar llafet
e Sokratit, Sokrat burokratit... Si ai do të bë-
hesh edhe ti?

BUSHI — (Ngrihet) Pusho!

Hyn Batoja

BATO — Ky burri juaj, sot në mëngjes po pinte
kafë me një shoqe...

BUSHI — Rri rehat, Bato, se nuk ta kam ngenë...

NËNA — Vazhdo, vazhdo, Bato...

BUSHI — E çka të vazhdojë? Po pija kafë me një
shoqe pune...

NËNA — Ashtu? Shoqe pune? Mës kishte pardesy
ajo shoqja?

BATO — Po për nder, e kishte vënë mbi gjunjë...

BUSHI — Mos gënje, Bato, ti e di se unë nuk gë-
njej!

NËNA — (I sillet të shoqit) Po ti, ore plak na paske
një shoqe me të cilën pike kafë. Prandaj nuk
më merr mua kurrë ndër kafene se shkôn me
të tjera...

BUSHI — Mos m'i shtje dreqërit! Të thashë se është
shoqe pune...

NËNA — Ashtu, ë? Po Lules ç'i the gjer tashti?

BATO — Si është puna?

BUSHI — Është tjetër muhabet ai... Të gjitha do
t'i dish ti, Bato!

BATO — (Lules) Ama, po zien kazani! Sokrati është
në siklet.

- Ndjen erë shtrëngate... Ja ke bërë paq...
- BUSHI — Mirë që ma kujtove Sokratin. (Lules) Përse e kritikon?
- LULJA — Se është burokrat.
- BUSHI — E shikon grua, ai që i ka shitur biletat, qenka burokrat!?
- LULJA — Pra, ai të paska llapur për mua! Do t'ia tregoj unë atij!
- BUSHI — Çfarë i tregon, moj? Po kush të le derisa të jem gjallë unë?
- BATO — Vajza jote është trimëreshë, Bush! Të kam thënë. E ngriti peshë gjithë ndërmarrjen!..
- BUSHI — Për këtë të besoj, se edhe shtëpisë sime po i vë flakën...
- BATO — Me sa flitet, për Lulen do të dëgjojmë gjëra më të mëdha...
- LULJA — Nuk është gjë ai muhabet, Bato!
- BUSHI — (Tregon pardesynë) Tani kemi boll këtë! Nuk më duhet më për sonte!

(Dëgjohet zëri i Luanit)

- BATO — Ka filluar të këndojë edhe ky!
- NËNA — E dëgjon tërë lagjja...
- BUSHI — Le të këndojë. Për të kënduar janë gjelat!
- BATO — (Tregon portën) Shoku Bushi, kur bëhen dy gjela, mundohen kush e kush të ngriejë zërin më lart!
- NËNA — Ashtu është, Bato.
- BATO — Edhe e keqja është se nisin të grinden, t'i hanë kokën njëri-tjetrit. Zakonisht gjelat e rinj janë më të fortë shoku Bush!
- BUSHI — Mos u bëj merak!

BATO — Mirë xhanëm, ashtu qoftë... Ngreu tani
e të dalim për rosa.

LULJA — (I sjell kafënë) Urdhëroni kafënë, xha
Bato!

BATO — Gëzuar, moj bijë... Të të uroj që tani?

LULJA — Lëre atë muhabet...

Bie perdja.

[Faint, illegible text, likely bleed-through from the reverse side of the page.]

PARASKENË

LANDI E LULJA

LULJA — Më deshe, teto Landi?

LANDI — Të desha, shpirt, e po hyj në temë fill.
E do atë djalin?

LULJA — (Skuqet) Cilin?

LANDI — Mos m'u skuq mua, po më thuaj: e do apo jo?

LULJA — Të paska treguar babai?

LANDI — Edhe punën e pardesysë, bile!

LULJA — Sa turp! Është sjellur keq!

LANDI — Mbrëmë është sjellur keq, e sot do të të fejojë!..

LULJA — Të më fejojë? (Qesh) Po me kë?

LANDI — Mos qesh! Nuk është për të qeshur! Dhe më ka caktuar mua shkuese!...

LULJA — Ty? (Qesh) Pranove ti?

LANDI — (Qesh) Si të mos pranoj unë?... Do të shkonte tek një shkuese tjetër e kjo do të ishte më keq për ty!

LULJA — Babai është i çuditshëm!.. Mendon se unë do të pranoj një fejesë me shkuesi si motit!..
Ikën ato kohëra tani.

LULJA — Mua po më vjen keq që paske pranuar...

Të dija plakë me zemër të re!...

LANDI — Mos u ngut të më gjykos! Gjersa erdha e të thashë, nuk jam si çdo shkuese! Babai yt ka një kokë që ta bën botën sterrë ty, nënës dhe motrave të tjera... Pra, nuk është mirë që të dalësh kundër me sopatë në dorë! Është mirë që helli të piqet e mishi të mos digjet...

LULJA — Ndonjë dredhi për t'ia hedhur babait si ndër opereta!.. Jo, teto, nuk më pëlqejnë plane të tilla! I kam zët...

LANDI — Edhe unë... Por ka akoma baballarë të tillë e për këta baballarë kanë faj të gjithë, pra edhe ti!...

LULJA — Ke të drejtë. Është lehtë të rrahësh gjoksin se nuk do ta dëgjosh babanë fanatik, por është më zor ta bindësh!... Kurse unë kam kaq telashe këto ditë në ndërmarrje!... Organizata e Partisë, m'i ka vënë të dyja këmbët në një këpucë!...

LANDI — *(I lëmon faqet)* Ti vazhdo si gjer tani dhe mos iu tremb punës! Ik tani se ai malukat është i mërziur... E sheh si na shikon?

LULJA — Mirupafshim. Ti je një grua e mirë. Një shoqe!

LANDI — Me këmbë të mbarë, bijë.

(Dalin të dyja)

Skena e rojes së ndërmarrjes. Dy-tri tavolina para klubit. Rrinë i pari dhe i dyti, që pinë dhe bëjnë muhabet. Batoja është në kamaren e tij.

BATO — *(Të dytit)* Ju cilin prisni këtu?

- I DYTI — Shokun Sokrat!
- I PARI — Edhe unë atë pres! (Pauzë) Sikur jemi parë diku...
- I DYTI — Në maternitet. Prisnim lajmin... Ika më parë... Ti, si dole?
- I PARI — Tani më kujtohet, se u bënë ca vjet. Ishte fëmija e parë. Vajzë më lindi... Ti, e mbaj mend, u ndave më mirë...
- I DYTI — Ç'ne... Ne u ndamë për faqe të zezë... humbëm!
- I PARI — Humbët? Ti u bërë me dy binjakë, në mos gabohe...
- I DYTI — Nuk e kam fjalën te binjakët por te undeshja... Na mundën!.. Unë prisja t'i bënim nja 4 a 5, se skuadër e dobët ishte. Na mundën! I nënvleftësuan këta tanët. Skuadra jonë është mendjemadhe. E kam thënë unë, more vëlla! A luhet futboll modern me pleq? Jo! Pastaj, ku kemi trainer ne!
- I PARI — Tani më kujtohet, se ti nuk çaje kokën për gruan, po për topin! Po tani, pse e pret shokun Sokrat?
- I DYTI — Më ka premtuar një çerdhe pëllumbash...
- I PARI — Çerdhe pëllumbash? Pse, mban edhe pëllumba ti?
- I DYTI — Jo, mor vëlla, ti qenke prapa botës. Çerdhe pëllumbash i thonë vendit të rehatshëm... Unë jam marangoz i kategorisë së shtatë...
- I PARI — Pastaj? Edhe unë elektrikist i kategorisë së shtatë jam!
- I DYTI — Dëgjo, vëlla, unë punoj në NSHN... Të-rë ditën në punë! Nuk kam kohë të lirë fare...
- I PARI — Pse, punon më shumë se tetë orë?
- I DYTI — Jo, më shumë nuk punoj, por është puna

se dua të punoj më pak... Shoku Sokrat ka në organikë një marangoz. Unë i rregullova një dollap në shtëpi dhe ia qita larg e larg që të më marrë mua marangoz...

I PARI — Këtu? Këtu nuk nevojiten marangozë!

I DYTI — Këtu është meseleja... se tërë ditën e dredh zinxhirin... Rrogën e kam njësoj e mund të shkëputem kur të dua për ndonjë punë private. E kupton vetë ti... gjersa është në organikë. S'ka si shoku Sokrat!... Po ti, pse e deshe shokun Sokrat? Të ka premtuar edhe ty ndonjë çerdhe pëllumbash?

I PARI — Jo, mua më dërgoi drejtori im, t'ia rregulloj shokut Sokrat reflektorin e zyrës së tij...

I DYTI — Ashtu, ë? (*Dialogu kalon në qoshen tjetër. Hyn Bushi me Lulen*).

BUSHI — Mirëmëngjes, Bato!

BATO — Oh, mirëmëngjes, Bush, po si m'ke njehë?

BUSHI — Mirë, mirë kam njehë, por cigare nuk kam...

BATO — (*Nxjerr paketën e vet*) Kam unë. Do ti një? (*Bushi refuzon*) Qenke i mërzitur sot?

BUSHI — Natyrisht, (*Tregon Lulen*) Kur nisin të rriten këto, hapu dorën halleve e telasheve.

(*Lulja i qesh Batos*)

BATO — Ama, aty ke të drejtë. (*Bushit*) Për çdo gjë rregullohet... Sot paskeni ardhur herët...

BUSHI — (*Shikon orën*) Vërtet, herët qenka. (*Lules*) Ti futu në fabrikë. Unë po shkoj pak në klub...

BATO — Shko, shko, një fërnet e një kafe ta largon mërzinë... (*I luan syrin Lules ndërsa Bushi nis*).

I PARI — (*Bushit që kalon*) Mirëmëngjes, shok!

BUSHI — Mirëmëngjes, po më falni se nuk po ju njoh!

I PARI — Vërtet? Nuk të kujtohet në maternitet?...
Unë prisja fëmijën e parë, kurse ti të gjash-tin...

BUSHI — Po, vërtet po më kujtohet! Dhe... vajzë, o i mjerë!

I PARI — I lumi thuaj! Ku ka më të dashur se bija ime?... Kur kthej në shtëpi, sikur çlodhem kur më hidhen si flutura...

BUSHI — Prit sa të rriten fluturat... Vajzat janë gaca!

I DYTI — Mos u mërzit, se kam unë 7 djem!

I PARI — Ky është ai tifozi, të kujtohet?

BUSHI — (Të parit) Kush me pasë 7 djem! (Të dy-tit) Sigurisht futbollista do t'i bësh?

I DYTI — Ta menr mendja! (Bushit) Do të pish një fërnet me ne?

BUSHI — Jo, faleminderit, nuk kam kohë. Do të pi në këmbë!..

I PARI — Si të duash. Dje u njoha me vajzën tën-de... Ama vajzë që ishte... Zhivë fare... E paç me jetë!

BUSHI — Faleminderit! (Hyn në klub)

BATO — (Në anën tjetër) Kështu, moj bijë... I mirë është yt atë, se shok e kam, por pak kokë-fortë... Uh, se gati harrova... Ti duhet të shkosh në komitet të Partisë që tani...

LULJA — Unë? Përse?

BATO — Nuk e di. Të thërrasin ty edhe sekretarin e Partisë, Skënderin. Ai u nis përpara... Vrapo edhe ti.. Kushedi përse të kërkojnë. Ik, bi-jë!...

LULJA — Shkova, xha Bato. Lajmëro shefin e repar-
tit!

BATO — E lajmëroj unë, ti mos u mërzit. Partia
veç për mirë të thërret.

SOKRATI — (*Hyn kur Lulja del*) E, mo Bato, si
vete?

BATO — Mirë, shoku Sokrat. Po ju qenkeni në qejf
sot!

SOKRATI — Edhe në qejf jam. Fjeta mirë mbrëmë...
Po ajo shoqja, Lulja, iku?

BATO — Shkoi në komitet... E kishin thirrur...

SOKRATI — Po, po, e di.. (*Fërkon duart*)

BATO — (*Me ironi*) Pse, do të marrin ndonjë masë
për të? Se, unë e di, ti nuk e sheh dot me sy
Lulen. Se të kritikon, prandaj...

SOKRATI — (*Fërkon duart e shkon nga klubi*) Tani
do të bëjë kritikë ajo! (*Sheh Bushin*) Shoku
Bushin, si jeni, si veni?

BUSHI — (*Me respekt*) Faleminderit, mirë!

SOKRATI — Morët vesh?

BUSHI — Çfarë?

SOKRATI — Për vajzën tuaj pra, Lulen!

BUSHI — (*I prekur*) Jo! Çfarë? Përsëri ajo?

SOKRATI — (*Fërkon duart*) E kisha paralajmëruar.
Ju kisha thënë, po ju nuk muarët vesh... Tani
e pat...

BUSHI — Shoku Sokrat, ç'ka ndodhur?

SOKRATI — Nuk ju tha se ku shkoi?

BUSHI — Në fabrikë. Unë me të erdha...

SOKRATI — Por tani u nis në komitet të Partisë!

BUSHI — Përse?

SOKRATI — Ja pra, për fyerjen që i ka bërë perso-
nit tim, autoritetit tim!..

BUSHI — Ç'do t'i bëjnë?

SOKRATI — (*Fërkon duart*) Po, ja, të lutem shumë...
Ka ligje, rregulla, norma të sjelljes ndaj kuadrove...

BUSHI — (*E kap për krahu*) Të pyeta se çfarë do t'i bëjnë bijës sime?

SOKRATI — Krahun, krahun të lutem shumë...

BUSHI — (*I lëshon krahun*) Më fal...

SOKRATI — Shoku Bushi, kuadri është i paprekshëm...

BUSHI — Shoku Sokrat, fol!

SOKRATI — (*Fërkon duart*) Po ja, o Bushi... Çfarë i bëjnë një njeriu që fyen një kuadër? E pushojnë ose e hedhin në gjyq!... Por unë nuk besoj të shkojë puna deri në gjyq... Kam zemër të butë... Pastaj, ju, ju kam në konsideratë, jua them shoqërisht. Jam principial. Kënaqem me pushimin e saj nga puna...

BATO — (*Nga kamarja*) Si kënaqet qeni! I ndrit fytyra...

BUSHI — Vajza ime të pushohet nga puna!? Pra ju e paskeni paditur se ju kritikoi në mbledhje?

SOKRATI — Jo se më kritikon, por më fyen. Pastaj unë nuk kisha nevojë të flisja. Mbrëmë në mbledhje kishte edhe një shok të komitetit... Ai i dëgjoi të gjitha dhe u indinjua për fjalët e Lulkës...

BUSHI — I thonë Lule e jo Lulkë...

SOKRATI — Ta thashë si përkëdheli. Pastaj njëlloj është...

BATO — (*Nga kamarja*) Njëlloj është si Sokrat e si Sokrap!

SOKRATI — Ju mos u çuditni, shoku Bushi... Kështu venë këto punë! Andaj jemi edhe të tillë...

E bën ti punën time? E bën? Të lutem shumë...
jo!

BATO — (*Me vete*) Jo xhanëm, se ti ke kokë të
madhe...

BUSHI — Natyrisht nuk e bëj, por kjo s'ka lidhje
me vajzën time!

SOKRATI — Ka, ka, ka...

BATO — Prap ngeli gjilpëra... Diku e ka hallin
ky!...

SOKRATI — Po, se vajza jote kujton se ne flemë
gjumë, se jemi mykur... Ajo s'e di se punën
tonë s'e bën dokushdo... Se jemi, si të thuash,
të pazëvendësueshëm... E di ti si tha drejtori
një ditë për mua? Të gjithë le të m'i heqin,
po Sokratin jo, se më prisni krahët! Ja, kështu
tha... E që ta kisha llafin, Lulka, pardon,
Lulja, të fyen!.. Punën e saj e tänden unë i
bëj kurdo... Se, ajo e juaja vetëm krahë do!
Po punën time e bën Lulja? Jo!... Sepse kër-
kon kokë e unë kam kokë...

BATO — Po, more, kokë ka edhe gomari, po gomar
i thonë!

SOKRATI — Atëherë gjersa nuk e bën dot, përse
përzihet në punët tona?

BUSHI — Po, por edhe të pushohet...

SOKRATI — (*Fërkon duart*) Po si të të them... Unë
të kisha paralajmëruar, se mpleksen gjërat, të
lutem shumë... Morali i vajzës nga njëra
anë...

BATO — Hë, qeni i biri qenit, prapë te morali ky!
Ia di pikën e dobët Bushit!

SOKRATI — Po unë kam zemër të mirë. (*Pauzë*)
Tani më fal se më presin ca persona atje. E
shikon vetë, nuk të lenë një minutë rehat, të lu-

tem shumë... Shkrihem i për fabrikën, na u zbardhën flokët për klasën punëtore, ndërsa di-sa nuk ta dinë... Mos u mërzit, shoku Bushi... Hajde, gëzuar!

BATO — Gëzuar, i tha maskarai.

SOKRATI — *(Të parit dhe të dytit)* Ju shokë e jani në klub... Unë nuk e kam pirë kafënë akoma... Llafosemi atje!

BATO — *(Del nga kamarja)* Bush, mblidhe veten, mos dëgjo Sokratin! Kushedi përse e kërkoni në komitet Lulen!..

BUSHI — Këta janë të mëdhenjtë e fabrikës. Këta e dinë... A e pe si fërkonte duart? Fajin e ka vajza ime... Ç'i duhet asaj të kritikojë njerëzit? T'i fyejë?... Pastaj, dëgjove se çfarë tha për moralin?... Se e ka për vetë!.. I ka shitur biletat e kinemasë... Ah, moj Lule, si po ma shkurtton jetën!.. Ja ç'telashe po më sjellin vajzat!

BATO — Mblidhe veten, mor budalla. Ç'telashe të sollën?... Lulja është nderi i ndërmarrjes!..

BUSHI — *(I prekur)* E pushuan nga puna. Pak të duket?

Bie perdja

PJESA E DYTË

Skena e shtëpisë. Nëna, si zakonisht, merret me ndonjë punë. Para portës që të çon në dhomën tjetër ku mësojnë fëmijët, janë rreshtuar disa këpucë, çizme, ndërsa mbi tryezë një palë gjyslykë dielli burrash. Radio jep muzikë gazmore.

- NËNA — Ke një orë me atë raki përpara.
- BUSHI — Po nuk e pi për qejf, moj, po prej hallit...
A e di ku e ke vajzën?
- NËNA — Ti më thuaj ku është Lulja që nuk ka ardhur akoma?! (*Hyn Landi*)
- LANDI — Mirëdita të gjithëve! Sa mirë shkoni ju të dy... Si pëllumbat që gugasin gu, gu, gu...
E solla mullirin, motër!...
- NËNA — Faleminderit, Landi. Lëre në dollap e ulu të të pjek një kafe...
- LANDI — (*I bën me shenjë për Bushin*) Nuk po ju prish muhabetin e ëmbël që paskeni zënë...
(*Bushit*) Komshi, si ma ke syrin? A je përsëri në ato fjalët e para?
- NËNA — Aman, moj Landi, një sahat e më parë se më plasi shpirti...

LANDI — Po deshe edhe për të tjerat të ndihmoj...
(Del. Hyn Lulja).

NËNA — A u lodhe, moj bijë e dashur? (I përkëdhel kokën) Ti paske edhe temperaturë... Mos je e sëmurë?

LULJA — Jo nënë, nuk kam gjë, po si të them...

BUSHI — Si të thotë?... Nuk ia shpërblen goja!...
(Qesh hidhur).

LULJA — Baba, mos u tall!

BUSHI — (Qesh me të madhe) Të tallem? E pse, moj bijë, vetëm ti të tallesh me ne? Me radhë është kjo punë!

NËNA — Lëre, more, vajzën rehat. A nuk e sheh se s'është mirë?

BUSHI — S'është mirë? Po mua a nuk më sheh se po plas?

LULJA — Aman, baba, në vend që të më ndihmosh, të më këshillosh... Unë tani, më shumë se kurrë, kam nevojë për ty...

NËNA — Po ç'të ka ngjarë, moj bijë?

BUSHI — (Ironik) Prit, grua! Lajmi i gëzuar, si ëmbëlsira, nxirret në fund dhe me salltanet... Ti po e sheh se nuk po ia shpërblen goja... Ka frikë se mos na bie alivan prej gëzimit... A nuk e sheh se edhe ajo është e gëzuar?

LULJA — Nuk jam e gëzuar, baba, mos u tall! Unë jam si e shushat...

BUSHI — E shushatur? E si të jesh ndryshe, derisa je femër?

LULJA — Baba!

NËNA — T'u thaftë goja, he fanatik... Keq po e ke prej femrave?

BUSHI — Unë keq? Unë jam si veshkla në dhjamë, a nuk e sheh? I rrethuar prej gjashtë femrave

- si prej gjashtë satelitëve... (Eërkon duart, af-
rohet tek gruaja)
- NËNA — Paska qenë në komitet të Partisë vajza.
- BUSHI — E di, e di.
- NËNA — E di, e di, e nuk ma ke treguar...
- BUSHI — Tash po e marr vesh vetë ti!
- LULJA — Isha me sekretarin e organizatës...
- BUSHI — Kush ju kishte thirrur?
- LULJA — Shoku sekretar i parë. Sa turp që kisha.
- BUSHI — D.m.th., tek ai i madhi të paskan dërguar!
Gjer tek ai paska vajtur puna...
- LULJA — Ai, me gojën e vet.
- BUSHI — Bukur, moj bijë, na nderoye shtëpinë...
- LULJA — Unë bija juaj jam, baba!
- BUSHI — Ti nuk je imja por e sat ëme!
- NËNA — Mbylle ore atë gojë!
- BUSHI — (Lules) D.m.th., bijë e dashur, të hoqën
nga reparti?
- LULJA — Më hoqën, baba...
- BUSHI — Nga shoqet, shokët... Nga ajo punë shumë
e mirë...
- LULJA — Edhe mua më vjen keq baba, por çfarë
t'i bësh...
- BUSHI — E dëgjon, moj grua... I ardhka keq!
- NËNA — E zeza unë!
- BUSHI — Tani është vonë të qahesh... Ta kishe
parashikuar...
- LULJA — E si ta parachikoj, baba, as mua nuk më
vajti ndër mend!
- BUSHI — Prit, bijë, sa të vijë Landi, do të sjell
edhe unë një sihariq të bukur!
- LULJA — (Qesh) Nuk ia kam ngenë atyre shakave
tani!
- BUSHI — Nuk janë shaka... Unë nuk bëj shaka!

- (Pauzë) Të vazhdojmë... T'i numëroj të gjitha sekretari? Një nga një? Që nga diskutimet e tua e deri të kritikave që u bënë të tjerëve?
- LULJA — Të gjitha m'i numëroi baba, bile tha edhe gjëra që s'i meritoja... Për mendimin tim, ishin të tepërta!..
- BUSHI — Pse nuk ia the?... Pse nuk kundërshtove?
- LULJA — Ia thashë, bile kundërshtova... I thashë se ka edhe të tjerë si unë, që ma kalojnë mua...
- BUSHI — Hee, paska edhe të tjerë!.. Po si t'u përgjigj ai?
- LULJA — Ma mbylli gojën! Të njohin shoqet e shokët e punës, më tha... Të njeh kolektivi... Kemi pyetur organizatën-bazë për ty! (Pauzë) Pastaj ai tha, se do ta shtrojmë edhe në kolektiv!
- BUSHI — Kë, moj? Çështjen tënde? Kur?
- LULJA — Nesër më duket...
- BUSHI — Grua, nesër jam i sëmurë... Nuk dal në punë se më vjen turp...
- LULJA — Edhe mua më vjen zor, baba, po ti mos u sill kështu me mua! Në vend që të më japësh zemër...
- BUSHI — Për çfarë, moj mortje, për çfarë të të jap zemër? Po a ke menduar për mua ndopak, për thünjat e mia, për djersën time, për qumsh-tin e sat ëme? A ke menduar më parë për këtë? Si do të dalim nesër para njerëzve? Do të na tregojnë me gisht: Ja, ai babai i Lules, ja ajo nëna e Lulkës! Dhe do të qeshin prapa nesh. A ke menduar për këto?... Dhe dashke të të jap zemër... Pa!
- NËNA — Po si thua ti, ta braktisësh vajzën në këtë çast të vështirë?

- LULJA — Baba, nënë, unë nuk po kuptoj! Përse nuk kini besim tek unë?! Ju ardhka edhe turp, përse? Përse? Cilët njerëz do të flasin për ju?
- BUSHI — Cilët?.. Gjithë qyteti! Të pushohesh nga puna për maskarallëqe, pak të duket?
- LULJA — Për çfarë, baba?!... Po a nuk e di ti, nuk e di ti, se si është puna?.. Nuk e di përse më kanë thirrur në komitet të Partisë?... Atë tani e ka mësuar e gjithë ndërmarrja!..
- BUSHI — Që e ka mësuar e gjithë ndërmarrja këtë e besoj, se shoku Sokrat atë punë ka... të përhapë lajme të këqija!
- LULJA — Baba, nënë... mua, mua... më bënë drejtoreshë!
- BUSHI — *(Qesh)* Hë, drejtoreshë!
- LULJA — Po, baba, drejtoreshë të ndërmarrjes sonë ku punojmë unë edhe ti! Drejtorin tjetër e ulën nga përgjegjësia e më bënë mua! Nesër i jepet kolektivit për aprovim!..
- BUSHI — Si the, moj ti, drejtoreshë e gjithë... *(Bën një hark)* e gjithë ndërmarrjes sonë?
- LULJA — *(Qesh)* Po, baba!
- NËNA — *(E përqafton)* Të keqen nëna ty! E dija se ç'vajzë kam... Ky ma ngriu gjakun!
- BUSHI — *(E largon të shoqen nga Lulja)* Prit, moj ti, njëherë... Ta marrim vesh mirë... Mua më thanë se të kanë thirrur në komitet për të njoftuar se të kanë pushuar nga puna... Ma tha shoku Sokrat me gojën e tij.
- LULJA — *(Qesh)* Sokrati?.. Hë, burokrati...
- BUSHI — Lëre dreqin e burokratit, po më thuaj... Ti tani do të drejtosh, të urdhërosh, të emrosh, të pushosh, të lavdërosh?

LULJA — Ç'uhua baba! Ndërmarrja ka Parti, organizatë profesionale, kolektiv...

NËNA — (Bushit) Na lodhe edhe ti me ato esh-oshet e tua!

BUSHI — (I ledhatar në sedër) Bija ime drjetoreshë? E unë budallai kujtoja se... Dale të të përqafoj!

NËNA — (Ndërsa Bushi përqafoi Lulen) E ç'të gjeti tani? E ndërrove pllakën? Ti nuk e ke përqaftuar kurrë vajzën tënde por e ke mallëkuar... (Hyn Landi gjithë shend e verë).

LANDI — (Pasi përqafoi Lulen, kur e sheh se Bushi po krekoset) Bushi, komshi, e solla!.. Po të shoh të gëzuar!.. D.m.th. se edhe vajza pranoi?... (I luan syrin Lules edhe nënës).

BUSHI — I gëzuar jam, posi. Si the? Kë solle ti?

LANDI — Siharinqin, ore! Siharinqin pra... Mbaroi ajo punë!..

BUSHI — Natyrisht që do të mbaronte kështu... Ësh-të bija ime kjo...

LANDI — (U luan syrin të tjerëve) Si je, mor komshi? Ke vajzë për nder!.. Ia ithashë të gjitha, prandaj ka ardhur e pret përjashta!..

BUSHI — (Ka harruar) Kush, moj, pret përjashta?

LANDI — Dhëndëri pra... A ti them të hyjë?

BUSHI — Kush të hyjë, moj?

NËNA — Ç'na ka katranoşur, mor burrë?

BUSHI — Prit, moj ti!.. Moj Landi, ku e ke fjalën?

LANDI — Si, ore, ku e kam fjalën? A je në vete?..

Ai pret përjashta se nuk pranon pa e parë Lulen!.. Të kam gjetur çfarë dhëndëri!.. Veteriner. Tani pak i moshuar është, nja 51 i ka, por vera e vjetër është gjithmonë më e mirë!..

LULJA — (*Qesh*) Baba, ç'janë këto fjalë?

BUSHI — (*Në sèkëlldi*) Asgjë, moj bijë... Se ç'përrallis kjo Landi...

LANDI — Unë përrallis?

BUSHI — Tani, shoqja Landi, e di si është puna... Puna është se vërtet e kemi pasur një muhabet bashkë, por ndërroi piligrami tani!...

LANDI — Çfarë piligrami more matuf!... A më the para një gjysmë ore: «Një sahat e më parë»... Tani mos më luaj bishtin se kam thirrë burrin e botës...

LULJA — Me që e ke sjellë, na e bjer ta shohim teto Landi... Unë nuk ia prish babait!..

BUSHI — Ik, moj Landi, në punë tënde e më lër rehat...

LANDI — (*Përqafton Lulen*) Urime, moj bijë... E dija unë se je nderi i lagjes... (*Bushit*) Të ishte për ty, o malukat, ti ia gjeje një plak...

Hyn Bato tërë gëzim.

BATO — A jeni në shtëpi?

BUSHI — (*Me vete*) Edhe ky e solli kokën!.. Kushe-di ç'do të kurdisë!.. (*Batos*) Hë de, kumbarë, urdhëro...

BATO — Gëzuar, moj shoqëri. Dy gëzime bashkë. (*Përqafton Lulen*) Urime Lule, shoqja drejtoreshë...

LULJA — Faleminderit, xha Bato!

NËNA — Gëzohen njerëzit e mirë...

BATO — Dinë kë zgjedhin punëtorët... Bash shënjit i kanë rënë... Ta dish sa janë gëzuar ata të turnit të dytë... Të presin me padurim...

BUSHI — Kaq shpejt e paskan marrë vesh?

BATO — Ata e kanë ditur edhe më parë, se organizata e Partisë është mbledhur për këtë punë, por ti... Të thoshja unë, Partia nuk mendon kurrë keq për njerëzit e mirë!

BUSHI — Është bija ime ajo!

BATO — Është bija e Partisë, në radhë të parë.

Nëna hyn me një kafe.

BUSHI — Aha, tarnake e paske bërë?.. Edhe një tjetër më prure?-

NËNA — Jo, këtë po e pi vetë!

BUSHI — Që kur kështu?

NËNA — Mua besa kafënë ma ka ënda gjithmonë, por e pi kur s'je ti në shtëpi...

BUSHI — Bre që mbaron shpejt... Po Lules pse s'ia poqe?

LULJA — *(Ngre kokën)* Nuk dua, baba!

BUSHI — Pije, pije se të mbledh mendimet... Një doktor i vjetër ka thënë...

LULJA — Po nuk ma ka ënda, baba...

NËNA — Lëre, mor, rehat derisa nuk e do... Në shtëpi të vet është...

BUSHI — Mirë, e lash... Por ama, sot pas mbledhjes shkuat në klub me ata shokët e komitetit... Çfarë pive atje?

LULJA — Një gotë birrë!

BUSHI — *(Shtrembëron buzët)* Birrë? Po, po, helbete, drejtoreshë...

NËNA — Besa, birra është e mirë, sidomos kur është e ftohtë... Si nuk na e bie në shtëpi ndonjë shishe, more burrë?

BUSHI — *(Përqesh)* Posi, moj e dashur! *(Ndërron ton)* Zeher thuaj!

- NËNA — Natyrisht, se je fanatik... Na bëre më turp mbrëmë...
- BUSHI — Të kam thënë njëzet mijë herë mos ma përmend të mbrëmshmen!
- NËNA — (*Vazhdon të sajën*) Medet që nuk e pamë atë dhëndërin! (*Pauzë*) Por kur e latë me Landin, burrë?
- BUSHI — (*Me inat*) Pusho, moj ti!
- LULJA — Nëna ka të drejtë...
- BUSHI — Ti, shoqja drejtoreshë, mos u përzje!... Drejtor i kësaj (*tregon nënën*) jam unë!... prandaj shkruaj...
- LULJA — Unë po shkruaj por ti e ke gabim. Mirë tha nëna...
- BUSHI — Ty nuk të doli keq që të ruajta që femijë... Ja, u bëre drejtoreshë!...
- NËNA — Posi, ore, për ruajtjen tënde u bë ajo!... E bëri shkolla, shoqëria...
- BUSHI — (*I kënaqur*) Kështu po, ka lezet. Dëgjo sa qetësi. As miza nuk dëgjohet... Ja, kjo është jeta. Qetësi, muzikë, disiplinë!
- NËNA — Dhe vetëm një gjel këndon...
- BUSHI — (*Lules*) Po lëri njëherë ato fletë...
- LULJA — (*E habitur*) Urdhëro, baba?
- BUSHI — (*E përkëdhel*) E dëgjon, moj grua? Urdhëro, baba! E kupton se këtu, në këtë shtëpi, drejtor jam unë! (*Lules*) Më bëhet qejfi se në mbledhje kishin thënë aq fjalë të mira për ty...
- LULJA — Ndërsa mua më erdhi turp... E tepruan një çikë...
- BUSHI — Punëtorët nuk e teprojnë kurrë. Ata dinë ç'flasin... Bile shoku sekretar të kishte thënë: «Urime, shoku Bush, që ke rritur një vajzë të tillë!» E dëgjon apo jo?

LULJA — Dëgjova, baba, dhe u gëzova!

BUSHI — Pse të mos gëzohesh? Të kam thënë se bota më nderojnë.

NËNA — Ata harrojnë se je anadollak, se në shtëpi përdëgjohet vetëm zëri yt, se...

BUSHI — Kur jam në qejf mos m'i fut mizat nën bisht... (I nënqesh Lules) Dëgjo, bije!

LULJA — Urdhëro, baba!

BUSHI — Nësër, në ç'orë vjen vetura të të marrë?

LULJA — Cila veturë?

BUSHI — Cila? Ajo e ndërmarrjes me të cilën vinte drejtori i parë!

LULJA — Aha, nuk do të vijë, baba...

BUSHI — Pse, është i sëmurë shoferi, ë?

LULJA — Jo, por i kam thënë unë... Përse të vijë?

Unë shkoj në këmbë, si gjithmonë... Makina është për tjetër gjë... për rrugë të gjata, për shërbime të rëndësishme... e jo për salltanet!

BUSHI — (Kollitet) Po, po, xhanëm... se ai drejtori i parë ishte rrezik edhe fëmijë e vet t'i dërgonte në shkollë me veturë! (Pauzë) Sa t'u bë rroga?

LULJA — Kush?

BUSHI — (Fërkon gishtat) Rroga, pra!

NËNA — Prapë ky...

LULJA — Ku di unë... Nuk më ka shkuar mendja te rroga... Pse të më shtohet?

BUSHI — (Qesh) Grua, e dëgjon? Pse t'i shtohet rroga thotë! (Lules) Ta merr mendja se të shtohet... Dyfish bile... Kanë për të vënë edhe telefon...

NËNA — Ky ka luajtur mendsh më duket...

LULJA — (Me keqardhje) Po ty, baba, pse të

- shkon mendja te këto gjëra? Ne jetojmë mirë, nuk na mungon gjë...
- NËNA — Se është çoroditur, prandaj...
- BUSHI — *(I zënë keq)* Se mos thashë gjë të keqe... Po ja, njerëz jemi... Gjersa i shtohet rroga duhet ta di sa i shtohet...
- NËNA — Hajde, gjel, hajde, po për rrogën gëzohesh a?
- LULJA — Kur të marr rrogën ty do ta jap... Nuk të ndal gjë...
- BUSHI — *(Me të butë)* Hej dreq, nuk e pata aty... Nejse... Ndërrojmë muhabet. Tani më thuaj, si e ke syrin?
- LULJA — Cilin sy, baba? *(Bie zilja)*. Dikush është në portë!... *(Del e hyn me një letër dhe me një tufë lule. Merr letrën dhe e lexon)*. «Shumë të respektuarës shoqes Lule, për lartësimin e personit tuaj jemi gëzuar sinqerisht, jashtëzakonisht, familiarisht... Urime, urime, urime... Kuadri me përvojë dhe eksperiencë, Sokrat Sokrati dhe bashkëshortja e tij Dafina...» *(Pauzë)* Servili!..
- NËNA — Kush është ky?.. E kishte shkruar me gishta atë letër...
- BUSHI — Ky, kush është ky? Ky është, horr, pizeveng! *(Lules)* Ktheja shpejt!
- LULJA — Nuk e dërgonte vetë po me një fëmi... Pastaj, nuk bën, baba... Lulet nuk kthehen... Urim është...
- BUSHI — E di unë se ku e ka hallin ai...
- LULJA — Baba, mos u bëj merak. Tani ne do të bëjmë një mbledhje për burokracinë, për ca nëpunës që janë mykur nëpër zyra prej dhjetëra vjetësh dhe që më tepër pengojnë punë se sa

ndreqin... Do t'i shkundim ato... Se na i frynë organikat në dëm të prodhimit... Le po, ky donte të krijonte edhe një ndërmarrje për grumbullimin e shisheve.

BUSHI — Ai ishte edhe prepotent!

NËNA — Çfarë ishte?

BUSHI — Prepotent! Njeri që, shante dhe bërtiste, që s'prekej as me pupël!

NËNA — Qenka si ti!

BUSHI — Më marrsh të keqen ti me gjithë Sokratin...

NËNA — Edhe ti tërë ditën bërtet, veç zëri yt dëgjohet në shtëpi! Bile, ti e thua vetë: në shtëpi këndon gjeli e jo pula!

BUSHI — E them për në shtëpi...

NËNA — Njëllor është, si në zyrë si në shtëpi...

BUSHI — Ku merr vesh ti, moj grua...

NËNA — Jo, more vetëm ti merrke vesh, se ne nuk lexojmë gazeta, nuk shkojmë ndër mbledhje, nuk shohim filma, shfaqje...

BUSHI — Atëherë, pse pyet për fjalën prepotent?

NËNA — Se nuk e dija, prandaj...

BUSHI — Mirë, mirë. (Lules) Na e dallashoi muhabetin kjo... Ku e kishim fjalën, moj bijë?

LULJA — Te syri, baba!

BUSHI — Po.

LULJA — Ti më pyete si e kam syrin, unë nuk të kuptova...

BUSHI — Ah, po! (Nënës) Dhe mos na u përzje në muhabet më. (Lules) Tani dëgjo, o bijë, mos rri si pulë!

NËNA — Gjel je vetëm ti...

BUSHI — (E shikon me inat) Haja arrat që në fi-

llim disave... Tash t'i kallzoj unë! Kush janë,
se il njoh mirë, dhe, mblihdja rripat! (Vajza
qesh) Ja, p.sh. sa të shkosh nesër në zyrë,
gjëja e parë që do bësh janë karriget e trye-
za...

LULJA — (Qesh) Kush?

BUSHI — Mos qesh por dëgjo... Sa të shkosh urdhë-
ro që të ndërrojnë pozicionin e tryezës, ishte
në qoshe, vëre te dritarja... Karriget vëri ndër
vende tjera. Sidomos perdet ndërroi menjëherë!

NËNA — Aman!

LULJA — Pse, baba?

BUSHI — Sepse kështu bëjnë ca drejtorë kur nisin
punën, që të tjerët të thonë që ndryshoi diçka
këtu! Kuptove?

LULJA — Baba, seriozisht e ke?

NËNA — Po, moj, po, seriozisht e ka... Dëgjoje,
dëgjoje...

BUSHI — (I ekzaltuar) Seriozisht fort, bile!... Pas-
taj, kur të vijnë njerëz për punë... Ja, p.sh.,
vi unë... Trokas.. (Troket në tryezë) Ti ç'du-
het të bësh?

LULJA — Unë do të them: hyrë!

BUSHI — E sheh?... Gabim, vajzë... Duhet ta lesh
tjetrin të trokasë disa herë... (Troket disa herë)
pastaj të thuash: hyrë!

LULJA — Pse, baba?

BUSHI — Që të të shtohet autoriteti... Kështu
bënte ai drejtori para teje...

LULJA — Po unë pse të bëj ashtu?

BUSHI — Të thashë, pra, për autoritetin... Pastaj, ku
e kisha fjalën... Hë, te urdhrat!... Ja, p.sh.,
më thirre mua se nuk kam zbatuar në kohë
një urdhër... Ti si vepron?

LULJA — (Qesh) Sipas rastit... Në fillim e pyes për shkakun!

BUSHI — E sheh! Gabim, gabim, bijë! Erdha unë...

Ti, as që çon fare kokën nga tryeza... (Ngrihet vetë) Më afrohesh... Atëherë, sikur vëren që jam aty, dhe më thua: Hë, mo bukurosh? Që kur ke nisur të borgjezohesh?... Dhe nis pastaj të më shash me ç'të vijë për dore...

LULJA — Baba, seriozisht e ke?

BUSHI — Natyrisht...

NËNA — Prit, bijë, se ka edhe më ky!

LULJA — Unë të sillem ashtu?... E përse?

BUSHI — Prit! Pastaj bëj pyetjet!.. Ku e kisha fjalën? Po, kur të bëhesh nervoz!... Se tani duhet të bëhesh nervoz më shumë...

NËNA — Qyqja!... Ky ose ka pirë ose...

LULJA — Pse të bëhem nervoz?

BUSHI — Mos u bëj, po shtiru sikur je bërë nervoz, dhe... (i bie me grusht tryezës) Ja, kësh-tu!... Të dridhësh zyrën, që të dridhen edhe ata që janë pranë teje!...

NËNA — Më trembe, he dreq!

BUSHI — Prit, hë!... Në makinë rri gjithmonë pranë shoferit dhe vër dorën në varëse... Nga makina mos përshëndet njeri, dua të them, ata që i ke nën vete... Bile fillo të mësosh ta grahësh vetë makinën... Bën përshtypje. Kështu bëjnë ca drejtorë...

NËNA — Po pse, more, drejtorë u thua atyre?

LULJA — Baba, ti po më çudit...

BUSHI — Prit, kam edhe më!... P.sh. shkon në një repart... U hedh një sy shkresave që t'i jep brigadieri ose përgjegjësi i repartit... Ti, ia kthen, pa i thënë asnjë fjalë, sepse po nuk i

fole, le të kuptosh se ke gjëra për t'i thënë, por nuk po i thua tani... Pastaj u drejtohesh punëtorëve me një buzëqeshje të lehtë: Hë, mo shokë? Do e realizojmë këtë muaj planin apo jo? Ata, natyrisht, thonë fjalët, e tyre, por ti nuk rri të dëgjosh se je duke ecur... U thua vetëm kaq në kalim: Ashtu, ju lumtë! Unë kam besim te ju!... I rreh njërit shpatullat lehtë dhe del... Brigadierin e lë të ecë pas teje e nuk e përfill fare, thua se nuk është aty...

LULJA — (Bërtet). Baba!

NËNA — Ti po e mëson keq vajzën, more burrë! Pusho njëherë...

BUSHI — (Vazhdon) Prit, bijë.

LULJA — Jo, baba, nuk dua të dëgjoj më! (E revoltuar) Unë kujtova se bëje shaka, ti e paske seriozisht!...

BUSHI — Po kështu kam parë të bëjnë ca drejtorë, moj bijë...

LULJA Po njerëzve të tillë punëtorët ua venë fshe-sën, baba! Ti mos më trego si bëjnë ata, po si bëjnë drejtorët e mirë, se të mirë i kemi të shumtët... Ti mos më fol për disa por për shumicën...

NËNA — I ngjet, vetë atyre të këqijve, andaj flet ashtu...

BUSHI — Mbylle, moj, ti...

NËNA — Po këto fjalë ke në gojë kur të djeg diçka: Mbylle, qepe!

BUHI — Unë, po e mësoj si të sillen që të ketë autoritet!

LULJA — Autoniteti fitohet me punë baba e me sjellje të mira.

Dëgjohet zëri i Landit nga jashtë.

LANDI — Bushi, Bushi, shoku Bushi. Erdha unë...
BUSHI — Dreq, erdhi prapë kjo... Grua, unë po dal
në kuzhinë...

NËNA — Janë vajzat atje...

BUSHI — Në dhomë të gjumit!

NËNA — Është Luani me një shopen e shkollës!

BUSHI — Po ku të shkoj tani? Nuk dua të më
shohë këtu!

Bie perdja.

SOKRATI — (Vë re) Me doli gjumi...

SOKRATI — (Vë re) Shikoj përjashta: shi! Me...

SOKRATI — (Vë re) Shikoj përjashta: shi! Me...

SOKRATI — (Vë re) Shikoj përjashta: shi! Me...

SOKRATI — (Vë re) Shikoj përjashta: shi! Me...

SOKRATI — (Vë re) Shikoj përjashta: shi! Me...

SOKRATI — (Vë re) Shikoj përjashta: shi! Me...

SOKRATI — (Vë re) Shikoj përjashta: shi! Me...

SOKRATI — (Vë re) Shikoj përjashta: shi! Me...

SOKRATI — (Vë re) Shikoj përjashta: shi! Me...

SOKRATI — (Vë re) Shikoj përjashta: shi! Me...

SOKRATI — (Vë re) Shikoj përjashta: shi! Me...

SOKRATI — (Vë re) Shikoj përjashta: shi! Me...

SOKRATI — (Vë re) Shikoj përjashta: shi! Me...

SOKRATI — (Vë re) Shikoj përjashta: shi! Me...

SOKRATI — (Vë re) Shikoj përjashta: shi! Me...

SOKRATI — (Vë re) Shikoj përjashta: shi! Me...

SOKRATI — (Vë re) Shikoj përjashta: shi! Me...

SOKRATI — (Vë re) Shikoj përjashta: shi! Me...

SOKRATI — (Vë re) Shikoj përjashta: shi! Me...

PARASKENË

SOKRATI — (*Ndërsa kalon Lulja*) Më doli gjumi, shoqja drejtoreshë... Shikoj përjashta: shi! Më vajti mendja te ju! Po sikur të dalë pa çadër shoqja drejtoreshë? Laget!.. Bëhet qull!.. Pastaj sëmuret.. Mbesim pa drejtoreshë... Të lutem shumë... Ia them gruas këtë mendim, bashkëshortes sime, Dafinës, d.m.th. ajo ma për-krah mendimin... Unë ngrihem nga shtrati, vishem e dal përjashta si vetëtima... Ja, sa arrita para shtëpisë... Kur ç'të shoh?! Ju dolët pa çadër!.. Nga punët e shumta! E parashikova kështu!...

LULJA — (*Qesh*) More shoku Sokrat, ç'më je ngjitur si rrodhe... Ku e keni hallin, xhanëm?

SOKRATI — Ju lutem, shoqja Lule...

LULJA — Lulkë, se kështu më thërrisnit dikur...

SOKRATI — (*Buzëqesh*) Ja, kishim të meta... Udhëheqja e ndërmarrjes na i vuri në dukje dhe ne po përmirësohemi...

LULJA — Tani shi nuk po bie, si e shikon. A mund të më thoni pse më dolët përpara?

SOKRATI — Si të them... E kam fjalën te propozimi i ca punëtorëve në mbledhje... Thanë se unë,

gjoja, qenkam hallkë e tepërt dhe u dashka të dal në prodhim... Tani, ne e dimë, se sa thonë njerëzit, të gjitha nuk janë të drejta, po desha t'ju ve në dukje, meritat e mia... (Nxjerr ca fletë) Këtu kam një fletëlavdërimi që ma ka dhënë organizata profesionale në vitin 1950... Është një artikull i gazetës «Puna» i vitit 1954, ku në mes të tjerash përmendet edhe emri im, d.m.th. i personit tim, si nëpunës i dalluar... Këtu ka rekomandim... Ky është raport i mjekësor, se nuk jam në rregull me tension, bile edhe në zbor kam aftësi të kufizuara...

LULJA — Po mirë, ç'më duhen të gjitha këto?

SOKRATI — T'i keni parasysh e, të lutem shumë, nëse dikush, po e zëmë, ngrihet e thotë që unë, personi im, të shkojë në prodhim...

LULJA — (Qesh) Ah, për këtë...

SOKRATI — (Nuk e kupton) Pra... Janë marrosur disa... Mendojmë se unë mund të shkoj në prodhim, unë që jam zyrtar që prej 25 vjetësh... Të lutem shumë, kësaj i thonë budallallëk... (Gjoja në vesh) Unë, nuk u ngrita të flas për atë Azizin, që foli kundër meje... Ju nuk e dini... Ai djalin e xhaxhait të gruas e ka zënë me një femër dhe e ka pushuar nga puna... Kam informata të sigurta...

LULJA — (Qesh) Kjo qenka interesante. Po pse nuk e thatë në mbledhje?

SOKRATI — (Qesh dhe ai) Pra nuk u ngrita... Bëra gabim... Po, po, jua them unë... Di shumë gjëra për ca persona që nuk e meritojnë atë vend që kanë...

LULJA — (Mendueshëm) Ashtu? Po mos kini shkruar

gjë një letër anonime, që erdhi dje? Fliste për ca kusure...

SOKRATI — (I zënë ngushtë) Unë letër anonime?

Unë... Ju lutem shumë... Unë...

LULJA — Nuk thashë se e kini shkruar po a e kini shkruar?

SOKRATI — Jo, unë nuk di gjë për atë letër...

LULJA — Mirë, ashtu qoftë... Po ne do ta gjejmë se kush e ka shkruar... Nuk lejojmë të fyhen njerëzit e ndershëm...

SOKRATI — Të fyhen?... Mos kanë shkruar edhe për mua në atë letër?

LULJA — (Qesh) Këtu është puna, se kanë shkruar edhe për ju, se gjoja, je i butë me njerëzit, se, nga që punon shumë, nuk kritikon punët e të tjerëve...

SOKRATI — E shikon? Më kanë fyer... Kjo është një provë se nuk e kam shkruar (unë) letrën...

LULJA — Ndërsa mua më vuri në dyshim, pikërisht kjo pjesë që fliste për ty. Ndërsa për të tjerët... vullte vrerë... Shkruante poshtërsi...

SOKRATI — Unë, për fjalë të nderit...

LULJA — Mirë xhanëm, derisa nuk e ke shkruar... Tani nisni për në punën tënde, se rrugën e di vetë... Dhe dëgjo...

SOKRATI — Urdhëroni...

LULJA — Mos më dil më përpara në rrugë, kupton?

SOKRATI — Më falni, ky ishte një rast... rast prishjeje moti...

LULJA — As në kësi rastesh... Sa për çështjen tënde, ti e di se çdo gjë e vendos kolektivi... Ai na njeh mirë të gjithëve... Shkoni!...

SOKRATI — E di... Ju nuk më mbani mëri... se,

gjoja, unë kam folur për ju të babai, shoku Bushi... Unë jam nisur si baba...

LULJA — Shkoni, ju lutem.. Mjaft më... (Sokrati del) Hë, ç'njeri i pështirë!... Gjer dje ishte tigër e tani lepur i pistë... (Del)

Hapet perdja. Skena e hyrjes së ndërmarjes. I pari dhe i dyti përshëri në tavolinë. I pari ka në dorë një reflektor. Batoja ndez një cigare. Bushi hyn i gëzuar duke fëshkëllyer.

BUSHI — Mirëmëngjes, Bato!

BATO — A, mirëmëngjes, Bush! Si u gdhive?

BUSHI — Mirë, mirë, po këndeje si venë punët?

BATO — (Qesh) Mirë venë... Mrekulli fare!

BUSHI — Natyrisht!.. Ndjehet se ka disiplinë tani këtu...

BATO — (Qesh) Natyrisht!..

BUSHI — Ndjehet se ka një kokë...

BATO — A ke një cigare?

BUSHI — Ti, në gojë tek e ke...

BATO — Është i fortë, dreqi... Më çon koll... Kurse ti e ke me filtër!

BUSHI — Unë me filtër?

BATO — Pse, mor, nuk i ke blerë me filtër?

BUSHI — Unë nuk e ndërroj duhanin të më falësh sa...

BATO — Gabim... Babai i drejtoreshës tani e prapa duhet t'i pijë cigaret me filtër, se, helbete, nuk është si të tjerët...

BUSHI — (E kupton ironinë) Ehuu, ke nge ti... Tërë ditën aty veç lloqe di... Unë po shkoj e pi një fërnjet se m'u tha fyti...

BATO — Mirë, veç shpejt. Edhe dy minuta fillon puna!

BUSHI — Atë e di unë... Ti, shiko derën... (*bën të dalë*)

BATO — (*Të parit dhe të dytit*) E, mo djelma, si veni, si shkoni, si ia çoni?!

I PARI — (*I çuditur*) Paska marrë superxhiro...

I DYTI — A e pe shokun Sokrat?

BUSHI — Sokratin... Hë, Sokratin... (*Futet në klub*)

SOKRATI — (*Hyn i shqetësuar*) Shoku Bato, shoku Bato!...

BATO — (*Del nga kamarja. Imiton*) Urdhëroni, shoku Sokrat!

SOKRATI — Mirëmëngjes! Si u gdhitë? Mirë? Gëzohem shumë... A e patë gjë shokun Bushi? Kâ ardhur apo akoma?

BATO — Ka ardhur dhe s'ka ardhur.

SOKRATI — Nuk ju kuptoj... ju lutem shumë...

BATO — Po ja, erdhi deri këtu dhe u fut në klub...

SOKRATI — (*I ndrit fytyra*) Në klub është akoma?

BATO — Po, por më fal, kur u bëre kaq mik me të?

SOKRATI — Unë mik e kisha edhe më parë...

BATO — (*Qesh*) Ama për mik që e kishe... (*Kujtohet. Tregon me gisht të parin dhe të dytin*) Ata dy burrat atje kanë dy orë që të presin... Erdhën dhe pyetën për ty!...

Sokrati i sheh, do të dalë, por ata vijnë dhe i zënë rrugën.

SOKRATI — Oboboo, ç'më gjeti (*Shkon drejt tyre*) Si jeni shokë, si shkoni e si ia çoni?

BATO — Mirë jemi e mirë ia çojmë. (*I jep reflektorin*) Jua rregullova në oficinë. Faturën do t'jua dërgojmë...

SOKRATI — Faleminderit shumë... I thua j shokut drejtor se Sokrati falenderon personalisht...

I PARI — Nuk ke përse ta falenderosh. Ju thashë se do t'ju vijë fatura!

SOKRATI — Fatura? Përse?

I PARI — Për ndreqjen...

SOKRATI — Po kjo ishte marrëveshje shoqërore mes meje dhe...

I PARI — Gjersa është bërë në orarin e punës do ta paguajë ndërmarrja juaj hakun...

SOKRATI — Kjo është e padrejtë. Reflektori është personal...

I PARI — Atëherë paguani ju! (*I jep dorën*) Hajde, gëzuar! Dhe tjera herë të vini vetë për ta ndrequr se unë nuk vij më! (*Largohet*)

I DYTI — Po unë, shoku Sokrat?

SOKRATI — Si? Çfarë?

I DYTI — Erdha unë...

SOKRATI — Për çfarë?

I DYTI — Si për çfarë? Të filloj punën, pra...

SOKRATI — Ku?

I DYTI — Te ju? E lashë punën ku isha e erdha të filloj këtu! Unë nuk e harroj kurrë këtë datë, se marr rrogën...

SOKRATI — Gabim, shok i dashur, ke ardhur gabim... Te ne nuk ka punë për ty...

I DYTI — Si nuk paska? Po më kini thënë vetë!..

SOKRATI — Unë të kam thënë!? Kur?-

I DYTI — Kur? More, mos luaj me mua ti, se kam lënë punën... Kam marrë edhe librezën e punës me vete...

SOKRATI — Gabim, të lutem, gabim... Të mos e kishe lënë punën... Nuk lihet puna për një ëndërr që kini parë. Unë nuk ju kam thënë as-

- njëherë se do të filloni punë te ne.. Se, që ta marësh vesh, unë as ju njoh fare...
- I DYTI — Si mor nuk më njihke? Po dollapin e shtëpisë kush ta bëri?
- SOKRATI — Një marangoz i zakonshëm, me para në dorë... Kjo nuk ka lidhje me çështjen... Unë ju thashë se nuk ju njoh e pikë...
- I DYTI — (*E kap për gjoksi*) More, me kë tallësh ti?
- SOKRATI — Ore, lëshomë! Ndhimë!.. Ndhimë!..
- BATO — (*Afrohet dhe i ndan*) Hej, o shok, ç'bën kështu ti?
- I DYTI — E meriton, or shok... Më kishte premtuar punë te ju'...
- SOKRATI — Gënjen!.. Unë s'i kisha premtuar gjë...
- I DYTI — Kush, more, gënjen?.. (*Do t'i bjerë*) Unë lashë punën, more faqezi!..
- BATO — (*Që i mban dorën*) Mirë, de, mirë... Të paska premtuar... Tani, edhe atë vetë e hoqën nga ai vend që kishte.. Tani dhe ai kalon në prodhim... megjithëse po bën të gjitha përçapjet që të gjejë prapë një zyrë...
- I DYTI — (*Qesh*) Ah, kështu qenka puna!...
- BATO — Kështu... Por e pati zor të ta thotë, se helbete i duket akoma si fyerje ta kalojnë në prodhim... Mendon se ka lindur vetëm për zyrë!
- I DYTI — Më fal, more i shkretë, se gati të mbyta!.. E unë më budalla që shkoj pas fjalës sate...
- BATO — Ti e kishe punën, pse e le?
- I DYTI — (*I bie kokës*) Unë nuk e lashë punën, po kështu i thashë këtij... Desha të kërkoj rehatinë edhe unë si ky pëllumbi! (*Sokratit*) Më dhe një mësim të mirë, shoku Sokrat, dhe, si falen-

derim, po të ftoj të vish tek unë e të punosh si nxënës... Për dy a tri vjet e fiton kategorinë e parë...

I dyti i jep dorën Batos dhe ulet pranë të parit në tryezë. Merr gotën dhe e çik me të parin. Ndërkohë Sokrati futet në klub.

BATO — Hej, ç'vete! Gati na la pa shokun Sokrat!
(Futet në kabinë. Muzikë. Kalon një farë kophe. Del Bushi me Sokratin, që i vihet prapa.)

BUSHI — Mirë, xhanëm, mirë, do ta shohim këtë punë... do ta shohim... Do ta bisedojmë me drejtorinë... Ti më sill raportin, por të jetë i fortë...

SOKRATI — Si urdhëron, me tri firma mjekësh...

BUSHI — Bukur fort. Sille ta shoh, ta studjoj...

Besoj, se mund ta rregullojmë ndonjë vend...

SOKRATI — Të falem nderit shumë, shoku Bushi...
Ju jini shpirt njeriu... Po përse nuk qëndruam edhe pak? Tani, posa erdhi një birrë e ftohtë prej Korçe!.. Të kishim marrë ndonjë shishe me bërxollë...

BUSHI — Me gjithë qejf, por puna, kupton, puna në radhë të parë...

SOKRATI — Si nuk ju kuptoj?... Ju lutem shumë...
Ju gjithmonë kini punuar mirë... Bile këtë muhabet kisha mbrëmë me Dafinën, bashkëshorten time. Po i thoja se shoku Bushi bie copë për punën...

BUSHI — *(Ndërsa Batoja e shikon me inat) Shiko tani. Ik e rregullo raportin. Bisedoj unë me drejtorinë. (I jep dorën)*

SOKRATI — *(Me servilizëm) Të rrofshin kalamajtë!.. (Del me vrap)*

- BATO — Bush, nuk bën mirë kështu!
- BUSHI — Po, ja pra, kam zemër të butë... më dhimbset...
- BATO — Nuk je në rregull, të them...
- BUSHI — Mjaft! Mjaft, se këto janë punë që nuk të përkasin... Ti shiko portën...
- BATO — Portën po e shikoj po edhe ti shiko punën tënde e mos e ampëro tët bijë!...
- BUSHI — (Do të hyjë) Ajo të mos më turpërojë mua... Se unë... (Rreh gjoksin) Hajde, tani më lësho rrugë...
- BATO — Ku shkon?
- BUSHI — Si ku shkon? Në punë, ku tjetër?
- BATO — Nuk bën... (Shikon orën) Turni ka 10 minuta që ka filluar...
- BUSHI — E di, po nuk më thotë gjë kush mua!...
- BATO — Po nuk të lë unë se...
- BUSHI — Kush? Ti?
- BATO — Po. Jam roje. Kam urdhër prej drejtorit shës që të mos pranoj njeri pas orarit të punës...
- BUSHI — Dakord. Dhe kështu të bësh!... Po mua.
- BATO — Ti, si tjerët...
- BUSHI — Jo xhanëm...
- BATO — Po xhanëm... Të thashë të mos vonohesh...
- BUSHI — More Bato, ti e di se kush jam?
- BATO — E di... Bushi je!...
- BUSHI — Hap rrugën pra...
- BATO — Shko në shtëpi Bush dhe po erdhe prapë vonë, ngele jashtë... Është forcuar disiplina tani në ndërmarrje, e the vetë...
- BUSHI — (Fillon të qeshë) Si tallet dreqi!.. Bato, tani mjaft u talle! Hape portën e pikë!

- BATO — Nuk e hap e pikëçuditëse!
- BUSHI — A e di se ç'të bëj?
- BATO — Nuk e di, po më thuaj.
- BUSHI — I them Lules... Dëgjo, hape portën të them.
- BATO — More, nuk e hap, kaq ta bësh dhëmbin!..
Ja, po marr drejtoreshën në telefon. Po tha ajo, dakord!
- BUSHI — Merre. Tash po ta mbledh ajo...
- BATO — *(Merr telefonin nga kamarja. Zëri i drejtoreshës dëgjohej nga megafoni)* Alo, shoqja Lule?
- LULJA — Po. Fol, Bato...
- BATO — Ju më kini dhënë urdhër që posa të fillojë turni, të mos pranoj punëtorë që vijnë me vonesë...
- LULJA — Po, asnjë njeri...
- BATO — Thashë se mos bëhet ndonjë përjashtim...
Është Bushi këtu... Erdhi pak me vonesë babaj juaj...
- LULJA — Shoku Bato, ju kam thënë asnjë njeri, pra, as babai im, kuptuat?!
- BATO — Si urdhëron... *(Mbyll telefonin)* Nuk dëgjon... i thashë...
- BUSHI — Si, mor, nuk dëgjon? Ma jep mua në telefon...
- BATO — Ta marr edhe një herë? Nuk mundem...
Ajo më tha...
- BUSHI — Ti bjeri numrit se dal vetë...
- BATO — Mirë veç... tash po më flet... *(Merr telefonin)* Ja, foli!
- BUSHI — Alo! Kush je?
- LULJA — Drejtoresha jam, po ju kush jeni?
- BUSHI — Hë, pse bën sikur nuk më njeh? Bushi jam...

- LULJA — Baba, si është puna?
- BUSHI — Si është puna? Puna është që të urdhërosh Baton që të më hapë portën, bile, edhe t'ia mbledhësh rripat, se i është rritur mendja keq...
- LULJA — Bato kryen detyrën, baba! Ti, pse erdhe vonë? Ishe në klub?...

I pari e i dyti nisin të qeshin në tryezë.

BUSHI — Se ku isha unë, nuk të jap llogari... Ti hap portën!..

LULJA — Jo. Edhe dita e punës sot do të të ndalet, kurse për vonesën do të japësh llogari përpara brigadës...

BUSHI — Moj Lule...

LULJA — Shiko, Bush... Këtu nuk jemi në shtëpi... Po më pengoni në punë...

BUSHI — Moj Lule, dëgjo, moj bijë e dashur...

LULJA — Shoku Bush, kjo është ndërmarrje e jo han. Ka disiplinë. Kjo është një për të gjithë.

BUSHI — *(Me përkëdhelje.)* E di, moj, e di, por thuaj të hapë portën...

LULJA — Mos pengoni rojen, ju lutem... Shkoni në shtëpi...

BUSHI — Në shtëpi po shkoj, po ti, a mendon se vjen në shtëpi?

LULJA — Shkoni tani...

BUSHI — *(Nervoz)* Mirë, moj, mirë... Tash po e shohim.. *(Ul telefonin)* Ah, moj Lule, mos ardhsh në shtëpi!..

BATO — Ta thashë unë... Drejtoresha ka vendosur një disiplinë të rreptë...

I PARI — *(Nga tryeza)* Eh, more babush, ta mblo-dhi drejtoresha!

BUSHI — (*Nervoz*) Babushi i tyt eti!

I DYTI — Edhe ti e pësove si unë... Eja tani e pije një gotë me ne...

BATO — Të thashë unë... (*Qesh*).

LUANI — (*Nga jashtë*) Xha Bato!

BATO — Urdhëro, bir... U, po ti mor Luan?

LUANI — Desha të bisedoj me babin...

BATO — Ja, ku e ke... Bushi, Luani të kërkon...

BUSHI — Luani? (*I afrohet*) Po ti, mor këtu?

LUANI — Jam vonuar në shkollë... Nuk më pranojnë në pa prindër... Ti e ke fajin që më çove të drutë... Eja tani e bisedo me drejtorin...

I PARI — (*Qesh me të madhe*) Ore, ç'vete këtu! Babush mos është ky trashëgimtari që prisje atje në maternitet!.. Ha, ha, ha, ha!

BUSHI — Ha, ha, ha, haa! Pse qesh kështu? Ky është po, shtylla e konakut floriri i babait, rrapatushi...

I PARI — E paç me jetë... Djalë i mirë qenka...

LUANI — Eja, babi, e mos i trego Lules se më bërtet... Ti e kishe fajin, të thashë...

BUSHI — Mirë, more bir.. Ta arsyetoj unë mungesën...

BATO — Po tënden?

LUANI — Pse, baba, edhe ti?

BUSHI — Ah, more Bato! (*Luanit*) Jo, mor babë, por dola pak se kisha punë...

I DYTI — (*Qesh me të madhe*) Ha, ha, ha! Or babush, pasi të kesh arsyetuar mungesën e djalit, sille djalin të arsyetojë mungesën tënde... Ha, ha, ha...

BUSHI — (*Nervoz*) Ha, ha, ha! .. Si qesh, si i marrë!...

Bie perdja.

PARASKENË

Sokrati duke ndjekur Bushin.

SOKRATI — Shoku Bushi, ju lutem shumë...

BUSHI — M'u hiq qafe. Kam hallin tim...

(Dalin) Hapet perdja. Skena e shtëpisë.

NËNA — Prap ke ndërmend të bësh shamatë?

BUSHI — Atë e di unë... *(Ngrihet e sillet rrotull karriges ku rri Lulja)* Bija e dashur, drejtore-sha e nderuar, si rri si qengj tani!..

NËNA — Ajo gjithmonë ka qenë e urtë...

BUSHI — Më turpëroi sot para të gjithëve...

NËNA — Mirë ta bëri, pse shkove vonë? Deshe të pish e të shesësh mend para të tjerëve se për ty nuk ka orar!..

BUSHI — Pra, e ditke edhe ti, ta paska thënë?

NËNA — Ajo nuk i fsheh asgjë nënës...

BUSHI — *(Lules)* Tani, pse nuk flet?

LULJA — *(Nxjerr rrogën)* Urdhëro rrogën, baba!

BUSHI — *(Pasi i merr paratë dhe i numëron)* Nuk të fola për rrogën... Thashë pse nuk flet një fjalë për turpin që më bëre?..

- NËNA — Çudi!... Sot nuk të pëlqeka rroga!
- LULJA — Nuk të bëra turp, baba! Kjo është disiplinë... Ti vetë na ke thënë se njeriu duhet të jetë i drejtë dhe i ndershëm, apo jo?
- BUSHI — Hë!
- LULJA — Po të ishte ti drejtor dhe unë të vija vonë, a do më pranoje ti?
- BUSHI — Hë...!
- NËNA — Fol, de, përgjigju!
- LULJA — Do më pranoje?
- BUSHI — Hë... Unë...
- LULJA — E kuptova, baba, dhe të falemnderit, se edhe ti do të veproje si unë... Dhe kam besim se edhe për këtë që do të them tani, do të më kuptosh drejt...!
- BUSHI — Hë...!
- NËNA — Të kupton ai, po foli ti...!
- LULJA — A të kujtohet, baba, kur më thoshje për atë djalin e të zotit të fabrikës së sapunit ku punoje ti para çlirimit. Të kujtohet kur më thoshje se ai sillej si kapadai dhe ju e kishit frikë!..
- BUSHI — Hë...!
- NËNA — Kjo përkthehet kështu: kuptova, bijë!
- LULJA — Sepse ishte e tyre fabrika, ndaj silleshin ashtu... Tani është e popullit, prandaj askujt nuk i lejohet të sillen ashtu dhe të hyjë e të dalë kur të dojë... (Pauzë) Baba, unë kam biseduar me ata të kuadrit... Ti duhet të largohesh nga ndërmarrja jonë, të punosh në një vend tjetër... Po me atë zanat, po me atë rrogë, vetëm vendi ndryshon...!
- BUSHI — (Kërcen) Unë të largohem nga ndërmarr-

- ja? Nga ndërmarrja ku kam punuar tash 30 vjet?... Unë?!..
- LULJA — Ose unë, baba! Të mos thonë se e kanë bërë ndërmarrjen si të familjes..
- BUSHI — Grua, a e dëgjon? Po më pushon edhe nga puna tani!
- NËNA — Ajo e di se ç'bën!
- LULJA — Mirë pra. Po shkoj vetë në komitet të Partisë e po i them të më heqin nga posti i drejtorit që nesër...
- BUSHI — Hë...
- NËNA — Hë... Hë... Këndeje më dhemb andej më djeg...
- LULJA — Të kam thënë që s'duhet të bëj lëshime ngaqë të kam baba!
- NËNA — S'ka lëshime për asnjeri, moj bijë!
- BUSHI — Hë...
- LULJA — Pse të ngel hatri ty e më merr inat?
- NËNA — Punë e madhe fort!..
- BUSHI — (*Sillet nëpër dhomë*) Hë, e kuptoj... Ti do që unë të jap fjalën që tani e prapa nuk do të vij vonë, se do të punoj mirë, se do të sillem mirë...
- LULJA — Ti punon mirë, veç të jesh më i thjesh-të...
- NËNA — Të mos jesh si ata prepotentët... —
- BUSHI — Hë...
- NËNA — Njëlloj je...
- BUSHI — Mbylle, moj,...
- NËNA — A e sheh? (*Lules.*) Nuk zë mend ky, jo!
- BUSHI — Më ka ndalur rrogën, moj, ime bijë, ka dhënë urdhër, kuptove? E si të mos bëhem me dreqër? A për këtë e rrita?

NËNA — Pse e paske rritur, për të shkelë rregullat e disiplinën për ty?

BUSHI — E kush tha ashtu? Po edhe të dënojë të jatin, kjo nuk është parë kund...

LULJA — Prandaj, baba, që ta kemi më lehtë të dy...

BUSHI — Moj Lule, jam babai yt, kupton?

LULJA — Po, babai im je! Veç ai baba, dikur dëgjonte fjalët e Sokratit!..

NËNA — Posi, posi...

LULJA — Tani ky baba përsëri dëgjon fjalët e Sokratit!

BUSHI — Unë?... Hë...

NËNA — I dëgjon, i dëgjon!

LULJA — Pranon të pijë me të e të bisedojë për raporte e stërraportel... Babá, më thoshje dikur mos prano lëshime, tani kërkon lëshime... Më thoshje dikur të jem e drejtë tani kërkon të jem e padrejtë?

BUSHI — Hë...

NËNA — Dëgjo, dëgjo... Bëj hë-hë, veç dëgjo...

LULJA — Thoshje dikur se vajzat janë lastare, tani kërkon të më thyesh vetë... Dikur kishe frikë nga fjalët e botës, tani me çrregullimet e tua kërkon që bota të flasin e të thonë: Ja, u bë drejtoreshë Lulja, dhe po i bën privilegje të jatit si në mall të babait! Harroi Lulja se e bënë drejtoreshë, pikërisht sepse ishte punëtore e do të mbetej punëtore, e ndershme dhe e drejtë...

(Hyn Batoja)

BUSHI — Hë...

BATO — Ajo ka të drejtë, Bush! Edhe ti e shëh se ka të drejtë!

NËNA — Foli, o Bato, se nuk merr vesh! —
BUSHI — Erdhe ti zotni? Ç'të kushtonte ty të më
cilje portën dhe të mos bëhej gjithë kjo zhur-
më?

BATO — Ama, këtë nuk e bëj, është shkelje...

BUSHI — Shkelje! E thua se më ke shok?

BATO — Shok të kam për gjëra të mira, për gjah,
për rosa...

BUSHI — Ik, ore, çfarë shoku je ti, më bëre me
turp!

BATO — E bëre veten, .. Po me Luanin si u bë,
e fute në shkollë, atë sëpaku?

LULJA — Pse edhe Luani qenka vonuar?

BUSHI — (Shfryn) Posi, shoqja drejtoreshë, sot jemi
vonuar familjarisht, babë dhe bir! U kënaqe?

LULJA — Sa turp!

NËNA — Turp e faqja e zezë! Na koritën meshkuj!

LANDI — (Nga jashtë) Bushi, shoku Bushi!

BUSHI — (Nënës) Si gjithmonë, vjen kur nuk dua
t'ia shoh surratin kësaj zevzekeje!

LULJA — (Qesh) Mua më duket grua e mirë dhe e
dashur...

NËNA — Boll e mirë është. Komshi më të mirë nuk
kemi.

BUSHI — Po ka një të keqe veç, që të ngjitet si
rrodhe...

NËNA — Mirë ta bën. Deshe shkuese, ja ku e
ke...

(Hyn Landi)

LANDI — Mirëmbrema, gjitonë! Si veni, si shkoni?

LULJA — Mir se erdhe, teto Landi!

NËNA — Ulu, të të pjek një kafe!

LANDI — E dua me sheqer shumë, e dua prej Bushit.

BUSHI — Me zehër!

LANDI — Mirë. Atij piqja si ta dojë!

BATO — Në ke ardhur për shkuesi, e ke kot...

BUSHI — A i lemë këto muhabete; se këto punë i rregullojmë vetë! Ti, Bato, besoj se u kënaqetani, apo jo?

BATO — E përse të mos kënaqem? Qysh se erdhi Lulja në krye, filluan të ndryshojnë të gjitha punët...

BUSHI — Ndryshuan për të zezën time...

BATO — Për të bardhë tënden e timen... Vetëm Lulja u kujtua për ne...

BUSHI — Sa për mua, është kujtuar bajagi mirë...

BATO — Jo vetëm për ty, po edhe për mua, për Kasemin, për Kolën, për Dudijen. Ja, nesër bëhet alamet mbledhje për të na nderuar!

BUSHI — Çfarë mbledhje, mor?

BATO — Kolektivi bën një mbrëmje për nder të punëtorëve të vjetër të ndërmarrjes... Edhe shfaqje do të japin për ne... Edhe fjalime do të mbajnë, edhe fletëlavdërime do të japin...

BUSHI — Kujt, mor?

BATO — Të gjithëve që përmenda, edhe ty!

NËNA — (*Qesh*) Edhe asaj Sadijes?

BUSHI — (*Shikon të bijën*) A është e vërtetë, moj bijë?

LULJA — Organizata profesionale ka vendosur. Unë nuk kisha ndonjë kundërshtim, ju e meritoni... Na kini rritur, na kini mësuar!

BUSHI — (*Të bijës*) Unë me të vërtetë se si jam bërë kohët e fundit...

LULJA — Jo, baba, jo!
 NËNA — Mos do të mbash ndonjë fjalim tani?
 BUSHI — Nuk do të ishte keq, moj grua... por nuk jam i zoti për fjalime... (Së bijës) Bile do të ishte mirë të filloja me një autokritikë, por nejse... sonte kemi gëzim!

FUND

BATO — E përse is mos këndem? Oqsh se erdhi Lulja në krye. Lulluna të ndryshojë të gjithë punët.
 BUSHI — Ndryshuan për të zezë time...
 BATO — Për të bardhë tëdherë të tjerë...
 Lulja në këmbë për me...
 BUSHI — Sa për mua, është kulluar baba, merr BATO — Jo vetëm për ty, do edhe për mua për Karamit për Hovin për Dushin, ja për këta hamet mabedhje për të pa ndërruar...
 BUSHI — (Tutë mabedhje, merr...
 BATO — Kolektiv për një mprekje për ndër të punëtorëve të vjetër të ndërruar...
 BATO — (Qesh) E baba, baba, baba...
 BUSHI — (Zëri i bijës) A është e vërtetë, moj bije?
 LULJA — Organizata profesionale ka vendosur. Unë nuk kisha ndonjë kundërshtim, ju e mendoni...
 Na kini titull na kini mësuar...
 BUSHI — (Të bijës) Unë më të vërtetë se të jave përë kohë të fundit...

Tirazhi 1000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1977